

# **SUNDIMI I LIGJIT NË KOSOVËN E PAVARUR**

Raport për Evropë Nr 204 – 19 maj 2010

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>i</b>
<b>I. HYRJE.....</b>	<b>1</b>
A. HISTORIKU.....	2
B. PROBLEMI KRIM.....	3
<b>II. POLICIA.....</b>	<b>6</b>
A. HETIMET.....	9
B. OPERACIONET.....	10
C. SHPËRDORIMET E BRENDSHME DHE KRIMET.....	11
<b>III. GJYQËSORI.....</b>	<b>13</b>
A. GJYKATAT .....	13
B. KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS .....	17
C. PROKURORIA .....	18
D. MARDHËNIET PROKURORI-POLICI.....	19
<b>IV. VERIU I KOSOVËS .....</b>	<b>20</b>
A. KRIMI .....	21
B. GJYKATAT .....	21
C. POLICIA .....	23
<b>V. KONKLUZIONE .....</b>	<b>25</b>
<b>SHTESA</b>	
A. HARTA E KOSOVËS .....	26
B. LISTA E SHKURTESAVE .....	27

## SUNDIMI I LIGJIT NË KOSOVËN E PAVARUR

### PËRMBLEDJE DHE REKOMANDIME

Dy vite pas shpalljes se pavarësisë Kosova ende përballet me sundimin e pabarabartë të ligjit dhe sistemin e dobët gjyqësor që po rëndonë mbi qytetarin e vendit. Policia, prokurorët publik dhe gjyqet – janë performues të çrregullt, të prirurë për t'u ndikuar politikisht dhe për keqpërdorim të detyrave. Krimi i orgnaizuar dhe korrupcioni janë mjaft të përhapur. Duke pasur parasyshë se prosperiteti, mardhëniet me Bashkimin Evropian (BE) si dhe njohja e Kosovës si shtet i pavarur varen nga sundimi i ligjit, qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, duke bërë zëvendësimin e zyrtarëve të lartë dhe aplikimin e stërvonuar të reformave, edhe pse ende vërehen dobësi kritike sidomos nëpër gjykata. Por korrupcioni i nivelit të lartë dhe krimi i organizuar janë mjaft të përhapura dhe në këtë mënyrë duke krijuar mjaft probleme, kështuqë qeveria e përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare duhet të veprojë me shpejtësi për ti zvogëluar dhe zgjidhur ato.

Kosova vuan nga përshtypja e krijuar se udhëhiqet nga një elitë e paligjshme politike që kontrollon cdo aspekt të shoqërisë. Nga një hetim i udhëhequr nga misioni për sundim të ligjit i BE-së, EULEX, dyshohet për korrupcion masiv në nivelet më të larta dhe janë evidentuar boshllëqe në ligje si dhe në zbatueshmërinë e tyre. Disa nga këto janë zgjeruar kohëve të fundit duke mundësuar kështu rritjen edhe më tej të korrupcionit. Ky reputacion mbanë jasht investimet dhe vendin të zhytur në varfëri. Nevoitet taktikë e dyfishtë e veprimt, forcimi i rregullativës në mënyrë që të pamundësohen mundësitë për korrupcion dhe në të njëjtën kohë hetimi i shkeljes së ligjit në të kaluarën.

Për më tepër, reputacioni i Kosovës për joligjshmëri është ekzagjeruar: Vendi ka nivel të ulët të kriminalitetit dhe në shumë aspekte është më i sigurtë se shumica e vendeve të zhvilluara. Rastet e krimeve ndëretnike janë të rralla dhe në pjesën më të madhe të Kosovës serbët jetojnë të sigurtë. Por sistemi gjyqësor është i dobët. Vetëm disa raste kriminale përfundojnë me burgosje të autorëve të krimit. Sistemi civil është edhe më keq. Është e pamundur për qytetarët e Kosovës – dhe kompanitë, vendore dhe ndërkombëtare, të cilat dëshirojnë të investojnë në Kosovë – të zbatojnë të drejtat e tyre në gjyq. Kontestet pronësore janë shumë të shpeshta dhe pasiqë nuk mund të zgjidhen në mënyrë të drejtë nëpër gjyqe ato në disa raste

bëhen burim i dhunës. Sistemi jofunksional i gjyqësisë civile, i ngulfatur me një grumbull rastesh të mbledhura që nga viti 2000-01, i frikëson investitorët.

Performuesit më të dobët në sistemin e gjyqësisë së Kosovës janë gjyqet. Nuk ekziston asnjë rrugë e besueshme që siguron shërim ligjor për sistemin civil të gjyqësisë. Gjyqtarë të demoralizuar dhe të rraskapitur kanë para vetes grumbuj të rasteve civile që vazhdojnë që para një dekade, të ndjekur nga një reputacion për korrupcion dhe favorizime. Paditësit mbesin enigmatikë gjatë raundeve të aeplit, shtyrjeve dhe vonesave, shpesh duke bërë gabime të qëllimëshme. Mitojsja dhe dhuna janë bërë mjete atraktive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve gjyqësore. Edhe pse sistemi i drejtësisë penale funksionon më mirë, ai vuan nga jobesueshmëria e përhapur, nga dëshmitarët e frikësuar dhe të pavullnetshëm për bashkëpunim dhe nga cilësia e ulët e punës së prokurorëve.

Policia është njëra nga pak institucionet vërtetë multi-etnike të Kosovës, ku serbët dhe të tjerët janë të integruar në të gjitha regjionet dhe në të gjitha nivelet. Ata kanë përkrahje të fortë publike dhe vullnet të fortë njerëzor por janë të menaxhuar në mënyrë të dobët dhe iu mungojnë aftësi vitale; pavarësisht nga kjo, lidërsihipi i policisë i shpërfillë trajnimet në mënyrë të vazhdueshme. Kjo forcë është mjaft efektive në punën rutinore si dhe me krimet e nivelit të ulët por ka mundësi të kufizuara për të luftuar krimin e organizuar, krimet financiare dhe mashtrimet, drogën dhe trafikimin njerëzor dhe sfida të tjera të specializuara. Ka zhilluar mardhënie miqësore me prokurorë public, të cilët kanë për detyrë që të udhëheqin të gjithat hetimet policore të krimeve serioze. Si rezultat i kësaj, policia vepron sipas vullnetit të vet ndërsa prokurorët janë nën shërbim dhe të mboshtur.

Institucionet të cilat duhet të monitorojnë sistemin gjyqësor – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), i cili i mbikqyrë gjyqtarët, Inspektoriati i Policisë së Kosovës (IPK) dhe ministria e drejtësisë, të cilët mbikqyrin prokurorët – nuk janë duke punuar. Këshilli është paralizuar nga pushime të gjata të stafit nëpër pozitat kyçe. Komponentet e tij, sidomos Zyra e Këshillit Disciplinor dhe Gjyqësori i Auditimit, përgjegjës për hetimin e korrupcionit dhe problemeve të tjera nëpër gjykata, punojnë

mirë, por gjetjet e tyre mbesin të paefektshme pasi që nuk vepron i tërë institucioni. Ministria vuan nga lidhshipi i dobët dhe nga mungesa e përkrahjes politike, edhe pse ministri i ri i emëruar në prill 2010 duhet të përmirësojë performancën.

Dobësitë e funksionimit të sistemit gjyqësor më së shumti janë të dukshme në veri të Lumit Ibër në Kosovë, në zonën e vogël të mbajtur nga serbët e cila në të vërtetë kontrollohet nga Serbia. Në Veri nuk ka drejtësi të vërtetë penale, pasi që gjykatat e udhëhequra nga Serbët atje nuk mund të bashkëpunojnë me Shpërbimin Policor të Kosovës (SHPK), të mandatuar nga KB. Megjithatë, Veriu nuk është zonë anarkiste: niveli i krimeve rutinore është i ngjashëm me nivelin e krimeve në Kosovë si tërësi, dhe numri i vogël i popullatës vendore jeton nga lëmosha e marrë nga Beogradi. Kohëve të fundit është rritur kontrolli i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe arrestimet mresëlënëse, kryesisht në Serbi, kanë ndikuar në zvogëlimin e dukshëm të kontrabandës. Por Veriu është një pengesë në mardhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe ndërmjet këtyre të dyjave dhe EULEX-it; ndikueshmëria dëmtuese e saj është shumë më e madhe se sa urdhëresat e pakëta ligjore të saj. Nga kujdesi i tepruar, EULEX-i nuk ka vendosur policinë e saj në Veri, duke lënë kështu këtë pjesë të lirë për veprimet e grupeve të organizuara kriminale të cilat janë të mërziqshme edhe për serbët më patriot. Përpjekjet e tij për të plotësuar gjyqin e Mitrovicës me gjykatës vendor kanë dështuar, duke ofenduar në këtë mënyrë edhe Prishtinën e edhe Beogradin.

Ky raport studion sistemin e brendshëm juridik; një raport pauses do të mbulojë aspektet ndërkombëtare.

## REKOMANDIMET

### Për Presidentin, Qeverinë dhe Kuvendit e Republikës së Kosovës:

1. Të përkrahin përpjekjet për të hetuar korrupsionin në nivelin e lartë dhe të parandalojnë përsëritjen e tij.
2. Urgjentisht të adaptojnë ligjet kryesore të kornizës për sistemin gjyqësor, duke përfshirë:
  - a) Ligjet për gjykatat, prokurorët dhe këshillet juridike dhe prokuroriale, dhe
  - b) Amendimin e kodit penal, kodit të procedurës penale dhe kodit të procedurës kontestimore;
3. Urgjentisht të emërojnë anëtarët e mbetur të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
4. Të krijojë një komitet të nivelit të lartë për të ofruar donatorët dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë me homologët e tyre në qeverinë e Kosovës, të:

- a) vejë qeverinë përsëri nën kontroll të vendimeve të rëndësishme legislative dhe organizative në lidhje me sundimin e ligjit, dhe
- b) detyrojë policinë, prokurorët, ministrinë për çështje të brendshme dhe ate të drejtësisë për të bashkëpunuar në luftën ndaj krimit.

5. Të dyfishojë, së paku, numrin e gjykatësve dhe prokurorëve dhe të sjellë pagat dhe pëfitimet e tyre në nivel me ato të degëve të tjera të shërbimeve të qeverisë, para zbatimit të plotë të reformës së sektorit gjyqësor dhe jo më vonë se 31 dhjetor 2010.

### Për EULEX-in:

6. Të japin ndihmë teknike dhe mbështetje politike për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) dhe për njësinë e hetimeve të brendshme të SHPK-së.
7. Të rrisë kapacitetin e Gjykatës së qarkut të Mitrovicës duke:
  - a) lehtësuar emërimin e gjyqtarëve shqiptarë dhe serbë, pa shkelje të integritetit të juridiksionit të Kosovës; dhe
  - b) transferuar detyrat e përshtatshme të personeli i kualifikuar ligjor vendor dhe ndërkombëtar.

### Për Policinë e Kosovës, Prokurorin e shtetit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ate të Drejtësisë:

8. Të përmirësojë bashkëpunimin prokurori-polici, duke krijuar ekipe për raste të rënda, dhe ekipe të specializuara për krime financiare dhe për krime të tjera të ndërlikuara.
9. Të mandatojë trajnimet për policinë dhe prokurorët për punë të specializuara në krimin e organizuar, drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore, krimet financiare dhe kundër-terrorizmit.
10. Të krijojë urgjentisht një bazë të dhënash të krimeve dhe rasteve, në mënyrë që policia dhe prokurorët të punojnë së bashku dhe të formulojnë një strategji efektive anti-krim.

### Për Qeverinë e Republikës së Serbisë:

11. Të marrë hapa për përkrahjen e forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë, duke përfshirë:
  - a) Kthimin e të gjitha dokumenteve zyrtare, përfshirë të dhënat pronësore dhe kadastrale si dhe lëndët gjyqësore të marra në vitin 1999;
  - b) të mbështesë emërimin e gjyqtarëve serbë me ligjin e Kosovës; dhe

- c) të bashkepunojë me EULEX-in dhe Kosovën për zhvillimin e strategjive ndërkufitare për pengimin e trafikimit të njerëzve dhe hyrjen ilegale të drogave.

**Për Bashkësinë Ndërkombëtare në Kosovë:**

- 12. Të mbështesë EULEX-in në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të lartë, dhe në veprimin në veri të Kosovës.
- 13. Të ushtrojë trysni të fuqishme mbi qeverinë për implementimin e sundimit të ligjit dhe për t'u siguruar se këshillat dhe ndihma ndërkombëtare janë të koordinuara dhe të qëndrueshme.

**Prishtinë/Bruksel, 19 maj, 2010**

## SUNDIMI I LIGJIT NË KOSOVËN E PAVARUR

### I. HYRJE

Kosova ka mbetur shumë prapa vendeve të tjera ish-jugosllave në aspektin e sundimit të ligjit, por shumë nga problemet e saj janë të ngjajshme me ato në rajon. Edhe Kroacia, e cila është në rrugë për t'iu bashkangjitur së shpejti BE-së, lufton për të përmbushur detyrimet e saj për sundim të ligjit, pavarësisht që ka pesëmbëdhjetë vjet prosperitet të qetë e paqësor dhe mbështetje të fortë ndërkombëtare. Keqqeverisja dhe shtypja serbe në vitet 1990, menaxhimi dashamirës por i dobët dhe joefektiv i administratës së OKB-së deri në vitin 2008, një shumëllojshmëri e këshilltarëve dhe donatorëve të huaj miëdashës që zhvillojnë plane jokompatibile, varfëria e thellë, dyshimi i thelluar në institucionet formale dhe procedurat, si dhe një udhëheqje me shumë pak përvojë qeverisëse kanë luajtur rolet e veta.

Sundimi i ligjit është përmirësuar në mënyrë të dukshme që nga periudha e administratës së përkohshme të OKB-së (UNMIK-ut, 1999-2008) dhe edhe më shumë që nga vitet e sundimit serb.<sup>1</sup> Arritje e madhe e qeverisë së kryeministrit Hashim Thaçi ka qenë menaxhimi paqësor i kalimit në pavarësi, duke ruajtur kryesisht trashëgiminë administrative të UNMIK-ut dhe në disa zona duke bërë riparimin e dobësive të trashëguara.

Por pothuajse asnjë nga bashkëbiseduesit e Grupit të Krizave në institucionet e gjyqësorit, policisë dhe të asociacioneve të ndërlidhura me to si dhe nga EULEX-i dhe zyrtarë të tjerë ndërkombëtarë nuk janë të sigurt se qeveria Thaçi mbështetë plotësisht sundimin e ligjit.<sup>2</sup> Shumë prej tyre kanë shprehur besimin për të kundërtën,

<sup>1</sup> Kosova gradualisht ka përpunuar renditjen e listës së sundimit të ligjit të Bankës Botërore, duke u reshtuar nga vendi i 13-të (nga 100) më 2003 në atë të 24-tin më 2007 duke u ngritur në vendin e 30-të më 2008, në vitin e parë të pavarësisë (në vlerësimin më të fundit). Pas Kosovës, Serbia është performuesi më i keq në ish-Jugosllavi, edhe pse është përmirësuar nga vendi i 19-të më 2003 në vendin e 40-të më 2008. Indikatorët e Qeverisjes Botërore, Banka Botërore, 2009.

<sup>2</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë në ministrinë e drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Zyra e Këshilluesit Disciplinor, Agjencioni Antikorrupsion dhe EULEX-i dhe prokurorë, gjykatës dhe diplomatë, Prishtinë, Bruksel dhe Uashington, DC, dhjetor 2009 deri në prill 2010.

se qeveria ka preferuar një gjyqësor të dobët. Një shoqëri dhe ekonomi e parregulluar është një mjedis ideal për korrupsion: krijimi i biznesmenëve të sukseshëm përmes lidhjeve, përderisa investimet tjera mbeten jasht. Në këtë pikëpamje, pagat jashtëzakonisht të ulëta të gjyqtarëve dhe prokurorëve tregojnë statusin e ulët të profesionit gjyqësor në qeveri dhe në shoqëri, mbajnë avokatët më ambiciozë larg shërbimit publik dhe krijojnë mundësi për presion dhe mitëmarrje në gjyqësor. Vonesat në miratimin e legjisllacionit me rëndësi kritike dhe në plotësimin e vendeve të lira për pozicionet kyçe në fushën e sundimit të ligjit gjithashtu mbajnë të dobët sistemin e funksionimit. Disa vëzhgues besojnë se elita e Kosovës nuk është mikëpritëse e investimeve të huaja, sepse ato rrezikojnë monopolet e tyre lokale, dhe se kompanitë e huaja nuk mund të mbështeten në sistemin e drejtësisë.<sup>3</sup>

Raporti i progresit i nëntorit 2009 i Komisionit Evropian (KE) e vlerësoi sistemin e drejtësisë si “të dobët, të pambrojtur ndaj ndërhyrjeve politike dhe joefikas” dhe vuri në dukje se “një kornizë jo e plotë ligjore, korrupsioni, sundimi i dobët i ligjit, niveli i lartë të aktiviteteve informale ... kanë vazhduar të pengojnë efikasitetin e mekanizmave të tregut”. Sipas kërrij raporti performanca e qeverisë në disa fusha është bërë edhe më e dobët, sidomos vërëhen përfitimet e jashtëzakonshme nga prokurimi publik.<sup>4</sup> U vërejt qartë se qeverisë nuk i pëlqyen këto kritika dhe ka filluar të marrë masa, duke përfshirë një lëkundje në ministrinë e drejtësisë, në ate të punëve të brendshme dhe në polici. Por qeveria duhet të bëjë shumë më tepër se kjo.

Bashkësia ndërkombëtare ka udhëhequr në masë të madhe procesin progresit të policisë dhe reformën e gjyqësorit, por me rezultate të përziera dhe në llogari të marginalizimit të qeverisë. Siç përshkruhet në detaje më poshtë, përfshirja e saj ka shkaktuar vonesa të gjata në miratimin e ligjeve të rëndësishme. Këshillëtarët e BE-së dhe të SHBA-ve shpesh nuk pajtohen lidhur meritat e sistemeve

<sup>3</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, ambasador perendimor në Kosovë, Prishtinë, 21 dhjetor 2009.

<sup>4</sup> “Kosova nën Rezolutën e KS-së së KB-së 1244/99, Raporti i progresit 2009”, Komisioni Evropian SEC (2009), 1340, 14 tetor, 2009, f. 11, 31.

të tyre përkatëse ligjore;<sup>5</sup> si pasojë Kosova është duke zbatuar dy sisteme të papajtueshme të kontrollit kufitar, njëra e favorizuar nga Uashingtoni, e të tjera e financuar nga KE. Zyrtarë në Bruksel thonë se modeli i SHBA-ve nuk është adekuat për të mbrojtur privatësinë dhe dhëna-ve të individëve,<sup>6</sup> ndërsa ekspertët nga SHBA-të argumentojnë se disa vendet anëtare të BE-së, të tilla si Malta, e kombinojnë këtë system edhe me mjete të tjera.<sup>7</sup>

Edhe pse policia kufitare e Kosovës është entuziaste për sistemin amerikan,<sup>8</sup> evropianët vazhdojnë të potencojnë atë që ata e shohin si ndikim të tepruar amerikan dhe deklarojnë se Agjensia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) harton legjislacion të ri për të cilin qeveria e Kosovës vetëm më pas konsulton KE-në lidhur me përputhshmërinë e kërrij legjislacioni me *acquis communautaire*.<sup>9</sup> Mospajtime të tilla do të vazhdojnë të ngadalësojnë reformat; përpos nëse qeveria merr kontrollin e agjendës së legjislacionit dhe bën koordinimin e ndihmës dhe të participimit ndërkombëtar.

## A. HISTORIKU

Sundimi i ligjit mbështetet në tri institucione kryesore: polici, prokurorët publik dhe gjykatat. Forca policore është shumë më e madhe se dy të tjerat: mbi 7000 pjesarë, krahasuar me më pak se 300 gjykatës dhe 100 prokurorë. Shumë mendojnë se policia është edhe më efektive se sa dy institucionet tjera dhe aftësitë e tyre për të luftuar krimin janë komprometuar nga joefektshmëria e prokurorëve dhe gjykatave.

Të tri institucionet u ngritën nga ajo që UNMIK-u themeloi në fillim të qëndrimit të tij, në kohën kur është ballafaquar me sfida të mëdha.<sup>10</sup> Autoritetet serbe duke u

larguar në vitin 1999 morën me vete të gjitha dosjet gjyqësore të Kosovës, të dhënat dhe pajisjet dhe nuk i kanë kthyer ato. Një dekadë e diskriminimit dhe abuzimit nën Presidentin serb Slobodan Millosheviç kishte larhuar me forcë shumicën e avokatëve shqiptarë dhe kishte diskredituar ata që qëndruan. Korniza ligjore për vete ishte nxirë nga lidhshmëria e krijuar me Millosheviqin. Rënia e pushtetit në verën e vitit 1999 ka lënë një grumbull të madh të rasteve civile dhe penale, duke filluar nga konestet pronësore deri te vrasjet e shumta. UNMIK-u duhej të ndërtonte një sistem të drejtësisë nga zeroja, dhe njëkohësisht të sigurojë rendin publik dhe duke negociuar bashkëjetesën me institucionet ad hoc të shqiptarëve.<sup>11</sup>

UNMIK-u ka ruajtur një ndarje strikte në mes të kompetencave të transferuara te Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), siq e quante qeverinë e Kosovës, dhe kompetencave të rezervuara për veten, duke përfshirë edhe kompetencat për sovranitetin, të tilla si punët e jashtme dhe doganat, si dhe ato të ndërlidhura me sundimin e ligjit, të tilla si policia, siguria dhe drejtësia. Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), me personel kosovarë, gradualisht mori kontrollin nga policia e UNMIK-ut, por mbeti t'i përgjigjej UNMIK-ut e jo IPVQ-së.<sup>12</sup> Shumica e stacioneve policore dhe shumë departamente nuk ka kaluar nën kontrollin e SHPK-së deri në vitin 2006, kur është edhe koha që UNMIK-u krijoi ministrinë e punëve të brendshme dhe ate të drejtësisë.<sup>13</sup>

Edhe pse kishte kërkuar me ngulm marrjen e kompetencave që kanë të bëjnë me policinë dhe drejtësinë, qeveria e Kosovës, kur erdhi koha e marrjes së kompetencave, u tregua e papërgatitur. Ajo u vonua për disa muaj në krijimin e ministrisë së punëve të brendshme dhe asaj të drejtësisë dhe fillimisht atyre u dha kapacitet të kufizuar, përderisa UNMIK-u ngadalësoi procesin e transferit të kompetencave të mbetura në fusha të ndieshme. Ndarja e pushtetit etiketoi policinë e sapokrijuar të Kosovës dhe gjykatat si të dominuara nga të huajt, jo tërësisht të Kosovës, dhe dobësoi efektivitetin e tyre.

UNMIK-u ka bërë shumë pak për të ndërtuar kapacitetin vetanak të Kosovës gjatë dekadës gjatë të cilës ka drejtuar

<sup>5</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar, Sekretariati i Këshillit të Evropës, Bruksel, mars 2010.

<sup>6</sup> Duke thënë se kështu i bëhet e mundur shtetit (përmes ndarjes së informatave, SHBA-të) qasja në tepër shumë informacione. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-sw, 24 mars 2010. Raportit i Programeve EULEX-it kishtë vënë re se sistemi "nuk përmbush kërkesat e Shengenit", fq. 80. Sistemi PISCES (Personal Identification Secure Comparison and Evaluation System), përshkruhet nga vetë krijuesi, firma amerikane Booz Allen Hamilton, si "një mjet kritik në luftën kundër terrorizmit"; [http://ëëë.boozallen.com/consulting/industries\\_article/659016](http://ëëë.boozallen.com/consulting/industries_article/659016).

<sup>7</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, departamenti amerikan i drejtësisë, Prishtinë, 22 mars 2010.

<sup>8</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartw i policies kufitare, Prishtinë, 10 shkurt 2010.

<sup>9</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-sw, Prishtinë, 24 mars 2010. "Acquis communautaire" janë ligjet e dhe rregulloret e BE-së të cilat duhet të merren dhe zbatohen nga secili shtet anëtar.

<sup>10</sup> Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave, numër 125, *Rruga e Kosovës (II): Standardi brendshëm*, 1 mars 2002, fq.

9-15, dhe numër 134, *Duke gjetur balancin; Nivelet e drejtësisë në Kosovë*, 12 shtator 2002, për informata më shumë rreth origjinës së gjyqësisë dhe policisë së Kosovës.

<sup>11</sup> Raport i Grupit të Krizave, *Duke gjetur balancin*, op. cit., fq. 1.

<sup>12</sup> "Raporti mbi situatën në Kosovë", Këshilli i Sigurimit i KB-së (UNSC) S/2004/932, 30 Nëntor 2004, fq. 17. Pas pavarësisë, policisë i është ndërruar emri në Policia e Kosovës (PK); oficerët serbë në Veri mbajnë emrin e vjetër, shenjën SHPK UNMIK.

<sup>13</sup> "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë", UNSC S/2006/707, 1 shtator 2006, fq. 4.



territorin. Ka krijuar një forcë policore me personel kosovarë por nuk ka trajnuar menaxherët e lartë të pavarur e as nuk ka krijuar udhëheqësit të fortë, duke mundësuar kështu paraqitjen e dobësive menaxheriale të cilat edhe sot e asja dite hendikepojnë PK-në.<sup>14</sup> Ajo nuk arriti të ripërtërijë stafin e moshuar në kuadër të juristëve dhe të bëjë plotësimin e nevojave për juristë dhe në këtë mënyrë lejoi grumbullimin jashtë normave të rasteve civile dhe penale. Shumë prej këtyre problemeve mbeten aktuale edhe tani. Numri i rasteve të papërfunduara në fund të vitit 2009 ishte mbi 200,000 dhe që atherë ky numër gradualisht është rritur.<sup>15</sup> Aktualisht numri i gjyqtarëve është më i vogël se sa në fillim të mandatit të UNMIK-ut, dhe praktikisht asnjë gjyqtar i ri nuk është emëruar.<sup>16</sup>

Ndërkohë transferimi nga OKB në BE nuk ka qenë i rrjedhshëm. Procesi i statusit përfundimtar i mandatuar nga OKB-ja kishte për qëllim të krijojë konsensus që do t'i lejojte Kosovës të bëhet e pavarur me bekimin e Këshillit të Sigurimit dhe me një mision tranzitor të BE-së për sundim të ligjit për të forcuar institucionet e saj dhe të monitoruar ecurinë e tyre. Kjo nuk ndodhi. Pasi veprimet e Këshillit të Sigurimit u bllokuan nga Rusia, Kosova shpalli pavarësinë e njëanshme, ftoi BE-në për tu vendosur në Kosovë duke transferuar disa nga kompetencat e veta sovraane te EULEX. Kosovarët e kuptuan këtë si një shkëmbim: ata do të pranojnë kufizime të përkohshme në sovranitetin e shtetit të tyre në shkëmbim me njohjen e pavarësisë së saj.

Por pasiqë OKB-ja dhe BE-ja nuk arritën konsensus, EULEX-it nuk mund të bënte pjesën e vet të punës sipas kësaj marrëveshje, prandaj në vend të kësaj ai u vendos si organizatë neutral lidhur me statusinën "autoritetin e përgjithshëm të OKB-së"<sup>17</sup> Kjo ka bërë që Kosova të ndihet e mashtruar ndërsa EULEX-i i konfuzuar. Një raport i mëvonshëm do të japë hollësi mbi marrëdhënien e vështira ndërmjet EULEX-it dhe qeverisë së Kosovës.

<sup>14</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartw i PK-sw, prill 2010; zyrtar i BE-sw, 24 mars 2010.

<sup>15</sup> Në fund të vitit 2008 kanë qenë 185,762 raste të papërfunduara dhe 213,967 në fund të vitit 2009. "Raporti për 2009: Statistikat në Gjykatat", Këshilli Gjyqësor i Kosovës, fq. 2.

<sup>16</sup> Në shtator të vitit 2002, kanë qenë 295 gjyqtarë dhe 46 prokurorë në; Raport i Grupit të Krizave, *FDuke gjetur balancin*, op. cit., fq. 11. Deri në mars 2010, vetëm 176 gjyqtarë kanë qenë ende në punë.; "Raporti për 2009", op. cit., fq. 2. Gjithashtu, kane qenë 79 prokurorë të cilët në vitin 2004 morën përsipër shumë nga detyrat të cilat më parë kryheshin nga gjyqtarë investigues; intervistë e Grupit të Krizave, Ismet Kabashi, kryeprokurori i Kosovës, Prishtinë, 31 mars 2010.

<sup>17</sup> "Përmbledhje e e intervenimit të Javier Solanës, përfaqësues i lartë i BE-së, para Takimit të Organizatave Ndërkombëtare Aktive në Terrenin e Kosovës", Këshilli i BE-së, S257/08, 18 korrik 2008.

## B. PROBLEMI KRIM

Kosova në vitin 2010 është vend shumë i sigurt dhe më paqësor se sa një dekadë më parë. Shkalla e vrasjeve ka rënë drastikisht nga 11,8 për 100,000 banorë në vitin 2000 në 2,9 në vitin 2005 dhe ndërmjet 2,6 dhe 3,2 në vitin 2009.<sup>18</sup> Këto shifra janë ende të larta në krahasim me mesataren rajonale dhe shumë më të larta se mesatarja e BE (edhe pse këto shifra janë më të ueta se sa në SHBA). Format e tjera të krimit të dhunshëm, të tilla si grabitjet, vjedhjet dhe vjedhjet e automjeteve janë, sipas PK, edhe nën mesataren e BE-së.<sup>19</sup> Por krimet nuk raportohen nga një pjesë e popullatës që ende në masë të madhe frikësohet nga policia dhe kështu mundësisht nuk preferon t'i përfshijë.<sup>20</sup> Askush nuk ka bërë një përpjekje "për hulumtimin nivelit të krimeve të mundshme të paraportuara në Kosovë".<sup>21</sup>

Vëzhguesit bien dakord se krimi i përditshëm i shkallës së ulët nuk është problem i madh, është sfidues niveli i lartë i krimit të organizuar në vend, trafikimi dhe korrupsioni.<sup>22</sup> Tregtia rajonale e drogës, e cila ka tendencë të jetë "shumë mirë i organizuar, i mbështetur nga korrupsioni në nivel të lartë dhe afër me tregjet e destinuar", kontribon pak në krimet e dhunshme lokale.<sup>23</sup> Përdorimi i drogës është i ulët, edhe pse disa droga sintetike janë importuar nga Serbia, dhe PK ka konfiskuar një dërgesë të kokainës nga Belgjika. Ekspertë perëndimorë e konsiderojnë Kosovën "kryesisht si një vend transit për drogën afgane të destinuar për në Evropë".<sup>24</sup> "Është e vështirë të sigurohen statistika të besueshme, edhe pse çmimi në rrugë i heroinës është dukshëm më i ulët se në vendet fqinje, dhe sygjerojnë përforsim të kontrollit dhe përpjekje më të mëdha për të stopuar këtë dukuri."<sup>25</sup>

<sup>18</sup> "Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e prekura", zyra e OKB-së për droga dhe krime, mars 2008, fq. 39; Raporti i Programeve i EULEX-it fq. 23. Popullata e Kosovës llogaritet të jetë mes 1.8 dhe 2.2 milion; figurat për kokë banori në këtë raport do të jipen në bazë të këtyre dy numrave.

<sup>19</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it, fq. 23.

<sup>20</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, officer i PK-së, Prishtinë, 12 mars 2010.

<sup>21</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it, fq. 37.

<sup>22</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të Kosovës dhe ndërkombëtarë, Prishtinë, janar-prill 2010.

<sup>23</sup> "Raporti botëror mbi drogat 2009", zyra e OKB-së për drogat dhe krimin, fq. 176-177.

<sup>24</sup> "Raporti mbi strategjinë ndërkombëtare të kontrollit të narkotikëve", Departamenti amerikan i shtetit, 1 mars 2010.

<sup>25</sup> Në Kosovë heroina kushton prej €10 deri €15 për gram, krahasuar me €15 deri €25 në Bosnje e Hercegovine dhe mbi €25 në Shqipëri, Maqedoni e Serbi; çmimet e marihuanaës dhe kokainës në Kosovë janë afër mesatares rajonale. "Evropë: Kosova ka çmimet më të ulëta të drogave ilegale në rajon", *Drug War Chronicle*, 26 shtator 2008.



Megjithatë, asnjë nga institucionet e përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit – policia, prokurorët, gjykatat, ministria e drejtësisë dhe ajo e punëve të brendshme e as EULEX-i – nuk e dinë as përafërsisht sa krime janë kryer, sa prej tyre janë hetuar me sukses apo janë ndjekur penalisht dhe çfarë ka ndodhur me autorët e këtyre krimeve.<sup>26</sup> Askush nga ata që I ka intervistuar Grupi i Krizave në PK, nuk kanë mundur të deklarojnë, për shembull, se sa vrasje ishin zgjidhur në vitin 2009. Ka një mospajtim në lidhje me numrin e vrasjeve, me ç'rast policia raporton numrin 52 ndërsa prokuroria 58. Kështu pretendimet e PK se ka ulur normën e përgjithshme të krimit për 5 për qind në vitin 2009 mund të mos jenë të besueshme.<sup>27</sup>

Konfuzioni njëjtë ekziston për krimin ndër-etnik. Në vitin 2009, sipas një raporti të policisë në dispozicion të Grupit të Krizave, janë kryer vetëm 25 krime të kësaj natyre. Megjithatë, prokurorët para janarit të vitit 2009 kishin të regjistruara në librat e tyre 320 krime të kësaj natyre, disa prej tyre datonin nga trazirat e marsit 2004 ose më herët, dhe 280 krime të tjera gjatë vitit 2009 (ku përfshiheshin 340 të dyshuar)<sup>28</sup> si dhe kanë vënë në dukje që shumica e këtyre rasteve janë përcjellur te PK. Gjykatat kanë dënuar më shumë se 350 njerëz për krimet ndër-etnike në vitin 2009 (shumica të kryera më herët). Një zyrtar i lartë serb i policisë tha për Grupin e Krizave se niveli i krimit ndër-etnik ndoshta mund të jetë pak më i lartë nga ajo që deklarohet zyrtarisht deh zakonisht nuk është me motiv ndër-etnik sic është për shembull rasti I ulja e e çmimit të tregut për pronat serbe.<sup>29</sup> Gjithashtu, informacionet në lidhje me krimet seksuale ndryshojnë shumë. Policia raportoi 174 raste në vitin 2009, ndërsa prokurorët pohuan se kanë pranuar vetëm nëntë raste nga policia.<sup>30</sup> Korrupsioni në nivel të lartë korrupsioni është problem më serioz. Në vitin 2009 Agjensioni Anti-Korrupsion i Kosovës (AAK) ka marrë 175 raporte, krahasuar me 130 raporte të pranuar një vit më parë, një rritje kjo që tregon për rritje të besimit në masë e poashtu edhe për ngritje të

vetëdijes.<sup>31</sup> Shumë nga ankesat ndërlidhen me gjykatësit dhe zyrtarët e gjykatave (53 raste të tilla, nga të cilat vetëm tetëmbëdhjetë janë referuar për ndjekje penale), zyrtarët e qeverisë kanë qenë subjekt i 34 ankesave, shtatëmbëdhjetë nga të cilat u janë referuar prokurorëve.<sup>32</sup> Kontratat e prokurimit publik përfshihen në shumicën e këtyre rasteve. Zyrtarët e lartë duhet të shpalosin të ardhurat dhe pronat e tyre në AAK, por shumica e kontratave janë të nënshkruara, në emër të mbikqyrësve të tyre, nga zyrtarë të rinj që nuk i nënshtrohen hetimeve, të cilët pranojnë ryshfet – ku 10 deri në 20 përqind e çmimit të tenderit duket të jetë shumë e zakonshme. Ministrinë, në disa raste, nuk kanë pranuar të bëjnë pagesë për punë të kryer në mënyrë që të kenë mundësi të mbajnë mito shtesë.<sup>33</sup>

AKA bën atë që mundet, por ndikimi i saj është i kufizuar, nga 168 raste që ka dërguar te prokurorët publikë që nga krijimi i saj, nga shkurti 2007 deri në fund të vitit 2009, vetëm pesë kanë rezultuar në padi dhe pesë të tjera në arrestime.<sup>34</sup> Ka shumë shpërputhje ndërmjet ankesës dhe dënimit – vet AKA, hetuesit e policisë, prokurorët dhe gjykatësit – të secili prej këtyre subjekteve një rast mund të vonohet, sabotohet apo të hiqet si rast.<sup>35</sup> Shefi I sapoemëruar I prokurorisë është ankuar se policia ka raportuar vetëm për një pjesë të vogël të rasteve të AAK, ai dhe shefi i ri i në divizionin kundër krimit në PK kanë identifikuar këto raste si prioritet.<sup>36</sup> Institucioneve të drejtësisë së Kosovës u mbetet që të padisin, të shpallin fajtorë zyrtarë të caktuar të lartë të qeverisë. Ashtu si në vendet e tjera ish-jugosllave, pavarësia është përcjellur nga një periudhë imuniteti për nivelin e lartë dhe pasurime të dukshme.

Ky imunitet mund të përfundojë. Rastet më të ndjeshme i janë transferuar EULEX-it, i cili, me sa duket, ka qenë duke punuar ngadalë.<sup>37</sup> Megjithatë, më 28 prill 2010, EULEX-i bastisi Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe disa vende të tjera në Prishtinë, duke përfshirë të gjitha banesat private të përdorura nga ministri, Fatmir Limaj, në kuadër të një hetimi që përfshinë “disa

<sup>26</sup> Grupi i Krizave ka bërë kërkesa të vazhdueshme orale dhe me postë elektronike në adresë të PK-së, ministrisë së drejtësisë dhe EULEX-it në lidhje me këtë informacion.

<sup>27</sup> Intervistw e Grupit tw Krizave, zyrtw te PK-sw, Prishtinw, 5 mars, 2010.

<sup>28</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, zyra statistikore, ministria e drejtësisë, 16 prill 2010, dhe statistikave të dhëna nga kjo e fundit Grupit të Krizave. Krimet ndër-etnike janë të gjitha të kryera nga shqiptarët e Kosovës ndaj joshqiptarëve (serbë, turqë, boshnjakë, romë, egjiptas dhe ashkalinjë), dhe ndaj shqiptarëve ku ata nuk janë komunitet shumicë (Kosova Veriore). Komunitet më të ndjeshme janë ato serbe, rome dhe egjiptase.

<sup>29</sup> Intervistw e Grupit tw Krizave, 17 mars, 2010.

<sup>30</sup> “Raporti për krime të Policisë së Kosovës për vitin 2009 dhe raporti i prokurorëve nga departamenti i statistikave, ministria e drejtësisë, dhënë Grupit të Krizave.

<sup>31</sup> “Raporti vjetor 2009”, KAA, fq. 7. KAA kishte vlerësuar rreth 30 milion euro humbje nga korrupsioni; “Raporti i Human Rights Report, Kosovë, 2010”, Departamenti amerikan i shtetit. Raporti vjetor 2009”, KAA, fq. 7-8.

<sup>32</sup> Raporti vjetor 2009”, KAA, fq. 7-8

<sup>33</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i KAA-së, Prishtinë, 12 janar 2010.

<sup>34</sup> “Raporti vjetor 2009”, KAA, fq. 16.

<sup>35</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i KAA-së, 12 janar 2010; zyrtar i lartë i hulumtimeve, departamenti i policisë, Prishtinë, 16 mars 2010.

<sup>36</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Kadri Arifi, ndihmësdrejtor policisë kriminale, Prishtinë, 31 mars 2010; Ismet Kabashi, kryeprokuror i Kosovës, Prishtinë, 31 2010.

<sup>37</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i KAA-së, Prishtinë, 12 janar 2010.

tendera që kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve në Kosovë në periudhën 2007-2009.<sup>38</sup> Dyshimi të Limajt, një ish-komandant me ndikim i UÇK-së<sup>39</sup> I liruar në vitin 2005 për krime lufte nga Gjykata Ndër-kombëtare Penale për ish Jugosllavinë (ICTY), u shfaq në 2009..<sup>40</sup> Deri në pranverë të vitit 2010, interesimi i EULEX-it për të ishte “sekreti politik I mbajnatur me së keqi” në Prishtinë.<sup>41</sup> Hetimi i EULEX-it u nda me komunitetin ndërkombëtar, me disa qeveri dhe Zyen Civile Ndërkombëtare (ZCN) duke shtyrë prokurorët dhe qeveri të tjera, duke përfshirë disa shtete anëtare të fuqishme e Kuintit, për një qasje të “butë”.<sup>42</sup> Limaj nuk është akuzuar e as nuk është marrë në pyetje, dhe ai ka mohuar çdo veprim të gabuar.<sup>43</sup> Ai ka refuzuar një post diplomatik jasht Kosovës si pjesë të marrëveshjes për tu larguar nga skena.<sup>44</sup>

Sic e ka përshkruar një artikull në media kohëve të fundit, nga viti 2007 deri në vitin 2009, ministria e transportit ishte në shpejtësi të madhe, duke ndërtuar rreth 1.000 kilometra rrugë përmes një numri të madh të kontraktorëve, me një kosto prej rreth € 170 milion.<sup>45</sup> Nëse EULEX-es vërtetohet se korrupsioni është i përhapur në kuadër të ministrisë së transportit, ministri i cili është përgjegjës për një pjesë të madhe të shpenzimeve publike, atëherë një numër i zyrtarëve të qeverisë mund të jetë implikuar.<sup>46</sup> Nëse EULEX-es vërtetohet se korrupsioni është i përhapur në kuadër të ministrisë së transportit, ministri i cili është përgjegjës për një pjesë të madhe

të shpenzimeve publike, atëherë një numër i zyrtarëve të qeverisë mund të jetë implikuar.<sup>47</sup>

Ky hetim, deri tani hetim i profilit më të lartë i nisur nga EULEX-i që prej vendosjes së tij në vitin 2008, është një nga disa raste të profilit të lartë që së bashku mund të përfshijë €100 milion ose më shumë.<sup>48</sup> Së bashku, kanë potencialin për të zbuluar probleme serioze në prokurimin e qeverisë dhe shumë lehtë mund të sfidojnë jo vetëm angazhimin e qeverisë për të luftuar korrupsionin, por edhe stabilitetin e lartë të saj. Reagimi fillestar nga ana e Qeverisë ka qenë pengues dhe mbrojtës.<sup>49</sup> Kompleksiteti, që kërkon analiza të hard drive-ve të kompjuterëve për të dhena ligjore dhe të kontabilitetit, ilustron dobësitë e PK dhe tregon nevojën për ndihmë - në formën e mbështetjes politike si dhe në ekspertizë teknike - nga ana e EULEX-it, ZNC-së, BE-së dhe SHBA-ve.<sup>50</sup>

<sup>38</sup> Njoftim për shtyp i EULEX-it, 29 prill 2010.

<sup>39</sup> Ushtria Çlirimtare e Kosovës, *Kosovo Liberation Army*.

<sup>40</sup> Lawrence Marzouk, “Fatmir Limaj, ndërtuesi i rrugëve të Kosovës”, *Balkan Insight*, 6 maj 2010.

<sup>41</sup> Lawrence Marzouk dhe Petrit Collaku, “Shokët e ministrit të Kosovës lulëzojnë nga “bonanza” e rrugës”, *Balkan Insight*, 8 prill 2010.

<sup>42</sup> Kuinti përbëhet nga Franca, Gjermania, Italia, Britania e Madhe dhe SHBA-të. Këto shtete kanë rol joformal në udhëheqjen dhe koordinimin e politikës ndërkombëtare karshi Kosovës. Intervista të Grupit të Krizave, diplomatë, Prishtinë, 12 mars 2010; Petrit Collaku dhe Lawrence Marzouk, “Lëvdata dhe nervozë pas bastisjeve të ministrit të Kosovës”, *Balkan Insight*, 6 maj 2010. ZCN-ja, e udhëhequr nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN), Pieter Feith monitoron implementimin e tranzicionit të Kosovës në pavarësi; PCN-ja ka kompetenca të gjëra ekzekutive të cilat deri më tani ka refuzuar ti ushtrojë.

<sup>43</sup> Petrit Collaku, “Limaj i Kosovës: ‘Jam i pastër si loti’”, *Balkan Insight*, 14 maj 2010.

<sup>44</sup> “EULEX-i nuk është pajtuar me ‘ekstradimin’ e Limajt”, *Koha Ditore*, 3 maj 2010, fq. 2; Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 5 maj 2010.

<sup>45</sup> Lawrence Marzouk, “Fatmir Limaj, ndërtuesi i rrugëve të Kosovës”, *Balkan Insight*, 6 maj 2010.

<sup>46</sup> Në vitin 2009, ministria e transportit kishte marrë pjesën e tretë më të madhe të buxhetit në shumë prej €115,897,975. Buxheti Kosovës, 2009.

<sup>47</sup> Partia Demokratike e Kosovës (PDK, *Democratic Party of Kosovo*) dhe më e vogla LDK (*Lidhja Demokratike e Kosovës, Democratic League of Kosovo*) janë formalisht partnerë koalicioni; marrëdhëniet mes tyre janë të tensionuara dhe shpesh të vrazhda. Intervista të Grupit të Krizave, udhëheqësit e PDK-së dhe LDK-së, Prishtinë, dhjetor 2009. Mediat raportojnë për investigimet e EULEX-it në fushën e arsimit, tregtisë, industrisë dhe ekonomisë e financave dhe se zyrtarët e lartë nga PDK-ja dhe LDK-ja, si dhe më e vogla Alanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ishin ndër të dyshuarit. “EULEX-i do të hetojë edhe 6 ish-ministra të PDK-së, LDK-së e AAK-së”, *Koha Ditore*, 11 maj 2010; Lawrence Marzouk, “EULEX: Limaj rrezikon burgim të gjatë”, *Balkan Insight*, 7 maj 2010.

<sup>48</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 5 maj 2010.

<sup>49</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 5 maj 2010; Collaku dhe Marzouk, “Lëvdata dhe shqetësim me rastin e bastisjes së ministrit të Kosovës”, op. cit.; “Kryetari i Kuvendit Krasniqi sfidon EULEX-in”, *Express*, 5 maj 2010; “Ligj, jo linç”, *Express*, 6 maj 2010.

<sup>50</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë nga shtylla për krim e policisë, Prishtinë, 31 mars 2010. EULEX-i ka vlerësuar se departamenti i hulumtimeve të krimeve ekonomike dhe korrupsionit është i vogël dhe joefikas; Programi i raportit i EULEX-it, fq. 41-42.

## II. POLICIA

Pavarësisht nga dobësitë e përshkruara më lart, policia është ndër institucionet më të forta të sundimit të ligjit<sup>51</sup> dhe në disa aspekte funksionojnë në nivel apo mbi nivelin e kolegëve të tyre në Maqedoninë fqinje, Malin e Zi dhe Serbi. Ata kanë fituar një reputacion për ndershmëri dhe përgjithësisht nuk përfshihen në rryshfete të vogla që njollosin shumë shërbime në Ballkanin Perëndimor.<sup>52</sup> Në radhën e institucioneve për sundim të ligjit është I vetmi institucion që funksionon me kapacitet gati të plotë në pothuajse të gjitha regjionet dhe departamentet si dhe ka përfaqësim të lartë të minoritetit serb, duke e bërë kështu PK “një organizatë shembull të policisë, në kuadër të Ballkanit Perëndimor dhe Evropë si tërësi”.<sup>53</sup> Duke marrë parasysh rrethanat kaotike dhe jetëgjatësinë e këtij institucioni, kjo është një arritje e shquar.

PK ka menaxhuar me sukses tranzicionin në pavarësi dhe në masë të madhe ka penguar incidentet ndër-etnike. Ajo e tejkaloi bojkotin e zyrtarëve serbë pas pavarësisë, kur, të inkurajuar nga Beogradi, më shumë se 300 zyrtarë serb nga Kosova qendrore dhe lindore lanë punën. Në veri, serbët nuk e lëshuan shërbimin, por e ndërprejnë komunikimin me zinxhirin komandues. Prishtina ishte i durueshme për më shumë se një vit dhe, në një përpjekje të bashkërenduar mirë me EULEX-in, përcaktuan qershorin e vitit 2009 si afat të fundit për kthim; pas të cilit afat do të rekrutonte oficerë të rinj. Shumica e zyrtarëve serb u detyruan të kthehen pasi e kuptuan se do të humbasin vendet e tyre të punës dhe se Serbia nuk do të mund t’I mbështesë ata financiarisht.<sup>54</sup> Siç është shpjeguar më në detaje më poshtë, megjithatë, PK në veri ka vazhduar praktikën e saj të mos raportojë nëpërmjet zinxhirit komandues në Prishtinë.

Problemet e mëdha janë përqendruar në nivelet e larta. 55 Përderisa performanca si tërësi është përmirësuar në krahasim me ditët e UNMIK-ut, institucioni ende dështon në disa aspekte të rëndësishme. Stafit udhëheqës i mungojnë aftësitë menaxhuese dhe vizioni si dhe është rezistent ndaj ndryshimeve. EULEX-i dhe institucionet tjera ndërkombëtare raportojnë se përpjekjet për trajnim të oficerëve në teknikat e përparuar për luftim të krimit janë kundërshtuar shpesh nga stafi i lartë i policisë, të cilët preferojnë qasjet familiare. Oficerë të rinj mbesin të frustruar nga mosdhënia e mundësive për t’i aplikuar mësimet e reja. 56 Menaxhmenti reagon negativisht ndaj kritikave apo hetimeve nga mediat, shoqëria civile dhe Inspektorati Policor i Kosovës (IPK). 57 Zyrtarët e lartë takohen rrallë me stafin e IPK-së, komandantët e satcioneve bashkëpunojë me Inspektoriatin vetëm sepse ata nuk kanë zgjidhje tjetër. Zbatimi i rekomandimeve është përmirësuar, por ende nuk është i kënaqshëm. 58 Disa në EULEX besojnë se këshillat e tyre drejtuar menaxhmentit të lartë janë injoruar nga komandantët që zotërojnë vendim-marrjen në seancat me dyer të mbyllura. 59

Policia ka aftësi të kufizuara për të hetuar krimet komplekse, të tilla si mashtrimet financiare, terrorizmi, droga dhe trafikimi njerëzor, korrupsioni i nivelit të lartë dhe krimi i organizuar. Ka dy arsye kryesore: PK ka pak përvojë apo trajnime në këto fusha, dhe mbetet objekt i ndërhyrjes politike dhe problemeve të sigurisë. 60 Në dy raste në vitin 2007, Grupi i Krizave ka qenë dëshmitar kur shefat e departamenteve kanë marrë telefonata me sa duket nga këshilltarë të dy ministrive të ndryshme të cilët kërkonin informacione rreth hetimeve specifike në të cilat ishin të involvuar anëtarë të familjeve të tyre apo bashkëpunëtorë të partive të tyre politike. EULEX-it beson se

<sup>51</sup> Shumë intervista të Grupit të Krizave në Prishtinë, mes nëntorit 2009 dhe prillit 2010, me zyrtar të Kosovës dhe ndërkombëtar, përfshirë diplomatë, EULEX-in, UMMIK-un dhe OSBE-në, kanë treguar pajtueshmëri të gjërë në këtë pikë.

<sup>52</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i sundimit të ligjit të UNMIK-ut, Prishtinë, 12 janar 2010; Hasan Preteni, drejtor, Agjencioni Anti-Korrupsion, Prishtinë, 12 janar 2010; Raporti i Programeve i EULEX-it, fq. 13. Një anketë e vitit 2009 tregon se vetëm një numër I vogël I banorëve ishin të pakënaqur me policinë dhe se në mesin e të pakënaqurve, vetëm 11 për qind thanë kishin thënë se korrupsioni dhe mito janë shkaqet. “Early Warning Report Kosovo”, Programi për Zhvillim i UN-it (UNDP), prill-qershor 2009, fq. 28-29.

<sup>53</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it, fq. 13.

<sup>54</sup> Serbia kishte ushtruar trysni ndaj serbëve të Kosovës, pjesëtarë të SHPK-së që t’I lënë vendet e punës në kohën kur ishte shpallur pavarësia e Kosovës, duke u premtuar kujdes financiar. Pas zgjedhjeve serbe të majit të vitit 2008, qeveria e re mori një qëndrim tjetër. Pjesëtarët serbë të SHPK-së ishin inkurajuar të ktheheshin në punë dhe Beogradi luajti një rol konstruktiv për tu siguruar që shumica e tyre ta bëjnë një gjë tillë.

<sup>55</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, këshilltar i ministrit të punëve të brendshme, Prishtinë, 21 prill 2010.

<sup>56</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të departamentit amerikan të drejtësisë, Prishtinë, 22 mars 2010.

<sup>57</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i inspeksionit, Prishtinë, 12 prill 2010; konsulent ndërkombëtar, Prishtinë, 31 mars 2010. Shih poshtë për inspektoratin e policisë.

<sup>58</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, ish-trajnuar konsulent, Prishtinë, 31 mars 2010. Inspektorati ka dërguar 156 rekomandime në adresë Komisionit Disciplinor të Policisë (KDP) dhe së shpejti do t’I dërgojë edhe 130 sosh. Drejtori general i policisë ka zbatuar 86 nga 99 rekomandimet e KDP-së. Intervista të Grupit të Krizave. Zyrtarë të PIK-së, konsulentë të OSBE-së, zyrtar i ministrisë së punëve të brendshme, Prishtinë, 21 mars 2010. Informata të dhëna Grupit të Krizave.

<sup>59</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë investigues i EULEX-it, departamenti ekzekutiv i policisë, Prishtinë, 16 mars 2010.

<sup>60</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të departamentit amerikan të drejtësisë, Prishtinë, 22 mars 2010; zyrtarë të OSBE-së, Prishtinë, 22 mars 2010.

edhe mbikqyrësit e policisë në disa raste kontaktojnë dhe iu japin informata të dyshuarve. 61

Marrëdhëniet e menaxhmentit të Policisë me qeverinë janë të rrjedhshme, sipas disa vëzhguesve që nga pavarësia ka pasur përmirësim të ketyre marrëdhënie e sipas disa të tjerëve ka pasur përkeqësim. 62 Vëzhguesit pajtohen se këto marrëdhënie ende mbesin mjaft problematike, dhe policia vazhdon të jetë favorite e figurave të fuqishme të qeverisë. Zyrtarët e lartë ofrohen me qeverinë, duke kërkuar punë për të afërmit, promovime dhe privilegje të tjera si të udhëtime jashtë vendit për trajnime të ndryshme. Ndërhyrjet politike mund të vazhdojnë edhe për disa kohë. 63 Disa në EULEX mendojnë se duhet të kalojë edhe një gjeneratë që PK të bëhet shërbim normal dhe plotësisht funksional. 64

Qeveria kohëve të fundit ka ndërmarrë disa hapa për të forcuar kapacitetet, duke emëruar një ministër të ri të punëve të brendshme dhe drejtorin e përgjithshëm të policisë. Ministri, Bajram Rexhepi, është një ish kryeministër (2002-2004) dhe një figurë e fuqishme politike, ai ka meritën për ruajtjen e paqes në qytetin e tij të lindjes, në Mitrovicën e ndarë, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. 65 Behar Selimi, ish-drejtor i Policisë Kufitare, një komandant i ri i njohur i cili ka marrëdhënie të mira me komunitetin ndërkombëtar dhe një zgjidhje konsensusi, mori përsipër funksionin e drejtorit të përgjithshëm në prill të vitit 2010. Paraardhësi i tij, Sheremet Ahmeti, ka qenë në pozita komanduese për një dekadë, por kurrë nuk krijoi një strukturë të fortë dhe u fajësua disa herë për disa dështime të të profilit të lartë të bëra nga policia. 66

<sup>61</sup> Për shembull, një major urdhëron investiguesin që ta përcjellë të dyshuarin; urdhëri shkon përmes lejtënantit i cili ia tërheq vërejtjen të dyshuarit. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë investigativ i EULEX-it, departamenti ekzekutiv i policisë, Prishtinë, 16 mars 2010.

<sup>62</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të departamentit amerikan të drejtësisë, Prishtinë, 22 mars 2010; zyrtarë të OSBE-së, Prishtinë, 22 mars 2010.

<sup>63</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, këshilltar qeveritar, Prishtinë, 21 prill 2010.

<sup>64</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë investigues i EULEX-it, departamenti ekzekutiv i policisë, Prishtinë, 16 mars 2010.

<sup>65</sup> Ish-ministri i punëve të brendshme Zenun Pajaziti kishte ardhur nga sektori i OJQ-ve, dhe gëzonte respekt për integritetin personal por shihej si i dobët politikisht.

<sup>66</sup> Protestat e Vetëvendosjes të vitit 2007, një vjedhje e madhe nga dhoma e evidencave në stacionin kryesor të policisë, më 25 prill të vitit 2009, dhe greva nga oficerët në uniformë më 2 shkurt të vitit 2010. Sipas raporteve të policisë të dhëna Grupit të Krizave, persona të panjohur kishin hyrë në dhomën e evidencave dhe kishin vjedhur, ndër tjera, rreth 47 kilogramë të drogërave të ndryshme, rreth €4,000 dhe rreth 6.5 milion lira turke (€3.25 milion). EULEX-i ka marrë përsipër investigimet;

Përveç disa njësive të specializuara, pothuajse të gjitha pozitat në polici janë të plotësuara, por struktura është ndoshta shumë e vogël për madhësinë e vendit, dhe personeli paguhet pak dhe është i paisur mjaft dobët. Çuditërisht, të pakët janë ata vëzhgues ndërkombëtarë të cilët avokojnë për zgjerimin e forcës, dhe EULEX-i nuk këshillon për ngritje të pagave. 67 Qeveria gjithashtu nuk sheh ndonjë nevojë për të punësuar oficerë të tjerë dhe do të preferonte të tkurrte edhe më shumë strukturën e policisë. 68 Numri i oficerëve të policisë në krahasim me numrin e popullsisë është pak më i vogël se në pjesën më të madhe të rajonit dhe shumë më i vogël se sa në disa shtete të BE-së. 69 Kosova duhet të marrë në konsideratë një rritje modeste në përmasa të kësaj strukture, 70 posaqërisht kjo vlenë për njësitë që janë të dobëta ose përgjegjëse për detyrat e krijuara rishtazi.

Pakënaqësia rreth pagave të ulëta ka implikime edhe në siguri. Për shembull, në shkurt të vitit 2010, 400 anëtarë të njësive elite të operacioneve të posaçme protestuan për pagesat jo të mjaftueshme, protestat u zhvilluan në uniformë dhe në objektet e policisë, ndërsa ata u tërhoqën, kur, pas katërmëdhjetë orë negociatash, qeveria ofroi një rritjetë buxhetit prej € 3.5 milion dhe pasi që ministri i punëve të brendshme premtoi se nuk do të ndërmirren masa disiplinore për pjesëmarrësit. 71 Në prill 2010

PK-ja asnjëherë nuk ka shpjeguar pikëpamjet e saj për ngjarjës. Ahmeti ishte i lidhur me ditët e UNMIK-ut, kur kosovarët nuk kishin pozita me kompetenca të plota. Intervistë e Grupit të Krizave, oficer i PK-së, Prishtinë, 6 prill 2010.

<sup>67</sup> Komenti i EULEX-it duket i paskrupullt: "Përderisa stafi i EULEX-it raporton se niveli i pagës është shkak për shqetësim në mesin e oficerëve të KP-së, megjithatë nuk mund të shihet si kërcënim madhor për stabilitetin e organizatës së PK-së në gjendjen e tanishme ekonomike në Kosovë. Punësimi i sugjertë, qoftë në sektorin publik apo privat, vazhdon të jetë i pamjaftueshëm për fuqinë punëtore në zgjerim, dhe policët kanë mundësi të kufizuara për punësim alternativ në rast të pakënaqësisë me kushtet në shërbimin policor". Rraporti i Programeve i EULEX-it, fq. 68.

<sup>68</sup> Intervista të Grupit të Krizave, këshilltarë të ministrisë së punëve të brendshme, Prishtinë, prill 2010.

<sup>69</sup> Kosova ka mes 327 dhe 398 policë për 100,000 banorë, krahasuar me 427 në Kroaci, 476 në Maqedoni dhe 540 në Itali.

<sup>70</sup> Ekziston një marrëdhënie e fuqishme mes madhësisë së poliisë dhe krimeve të raportuara; vendet me polici me staf të mjaftueshëm gëzojnë numrin më të ulët të krimeve të dhunshme. Llogaritjet e Grupit të Krizave të bazuara në informatat në Raportin e Programeve të EULEX-it, fq. 21. Korelacioni është edhe më i fuqishëm nëse krime më serioze sikurse që janë vrasjet janë në numër më të madh. Për shembull, Anglia dhe Uellsi kanë pk policë në raport me popullatën (272 për 100,000 banorë) dhe njëren nga nivelet më të larta të krimit në BE (10.4 krime serioze për 100,000 banorë). Italia ka gati dyfish më shumë policë për kokë banori dhe gati përgjysmë më pak krime serioz.

<sup>71</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, këshilltar i qeverisë, Prishtinë, 21, prill 2010.

qeveria e ka lejuar PK-në për të shfrytëzuar edhe një tjetër shumë prej € 3.5 milion për rritjen e pagave, të marra nga kursimet e bëra diku tjetër në kuadër të buxhetit të policisë, në mënyrë që të dy rritjet së bashku të mundësojnë rritjen prej rreth € 80 të pagës mujore mesatare të policit. Pagat e policisë të variojnë nga 320 € në muaj për personelin administrativ, 395 € për hetuesit dhe 440 € për oficerët për mrojtje të afërt.<sup>72</sup> Kjo mbetet vlerë e ulët në krahasim me rajonin – në Bosnjë dhe Hercegovinë shërbyesit në polici paguhen dy herë më shumë – por megjithatë kjo nuk është vlerë e ulët kur shikohen të ardhurat e ulëta për banor që shënohen në Kosovë j.<sup>73</sup> PK-ja duhet të mbajë së paku këtë nivel të të ardhurave, pa shkurtime të tjera në fusha të tjera kritike buxhetore.

Aftësia për të luftuar krimin është cunuar nga një paaftësi për të përdorur të dhënat e krimit: policia ka vetëm kapacitet bazik për menaxhimin e të dhënave.<sup>74</sup> Menaxherët e PK-së nuk duken të gatshëm të përdorin të dhëna statistikore, si një mjet për të analizuar objektivisht punën.<sup>75</sup> Raportet e policëve për krimet nuk janë të përputhshme, dhe zyra qendrore nuk i harmonizon të dhënat nga komanat rajonale.<sup>76</sup> Sistemi i informacionit (SIPK), është shumë i vjetër dhe i pasigurtë sa që “Drejtoria Krimeve të Mëdha dhe të Krimit të Organizuar nuk pranojnë të jofrojnë të dhënat e tyre”.<sup>77</sup>

PK-ja nuk ka statistika të besueshme për vrasjet dhe nuk është në gjendje të deklarojë se sa prej tyre janë dërguar për ndjekje penale, apo madje edhe për sa prej tyre i dyshuari është i njohur. Statistikat e vrasjeve që I janë dhënë EULEX-it janë të paqarta, ose për shkak se nuk ka informacion të besueshëm në lidhje me rastet, ose për arsye se EULEX-i nuk është në gjendje që të kuptojë formën e futjes së të dhënave nga ana policisë; sido që të jet, të dy këto shpjegime janë shqetësuese.<sup>78</sup>

EULEX-I ka identifikuar këtë problem në korrik të vitit 2009 dhe ka krijuar tri “faction fiche” që synojnë korri-

gjimin e këtij problemi.<sup>79</sup> Është shqetësues fakti që, jo vetëm që PK-ja nuk ka bërë asnjë përpjekje të dukshme lidhur me këtë, por EULEX-i ka pezulluar përpjekjet për të krijuar një sistem të përbashkët për policinë, prokurorët dhe gjykatat, duke gjykuar se kjo është e pamundshme të realizohet pa përmirësimin e sistemit të të dhënave Brenda PK-së.<sup>80</sup> Problemi ka disa rrënjë. Oficerët e policisë nuk i raportojnë krimet në mënyrë uniforme dhe policia përdorë tri baza të ndryshme të të dhënave të cilat janë të papërputhshme me njëra tjetrën dhe pamundësojnë ndjekjen e krimit.<sup>81</sup> Pa një sistem të përbashkët, është e pamundur për të përcjellur se çfarë ndodhë me rastet e veçanta, pasi që një krim i kryer në një vit (dhe i regjistruar nga policia) mund të çojë në një padi në një vit tjetër (të regjistruar nga prokurorët) dhe në një gjyq në vitin e tretë (dhe kjo paraqitet në statistikat e gjykatave). Policia kanë tendencë për të raportuar numrin e krimeve, ndërsa prokurorët përqëndrohen në numrin e të dyshuarve. Policia iu dorëzon prokurorëve dosjet e rasteve pa identifikuar të dyshuarit, në zyrën e prokurorit komunal të Prishtinës, gjatë vitit 2009 ka pasur rreth 5000 raste të tilla.<sup>82</sup>

Ky nuk është një problem i pazgjidhshëm. Nevoitet një gatishmëri për të bashkëpunuar në një bazë të dhënash të thjeshtë ku bëhet e mundur përcjellja e informacioneve bazë për të dyshuar, raste, krime dhe dispozita. Mungesa e këtij informacioni kufizon efektivitetin e menaxhmentit të policisë, i cili nuk mund ta dijë, për shembull, se cilat stacione apo njësi prodhojnë raste që dërgohen për padi dhe cilat jo. Kjo është pjesërisht problem i policisë dhe pjesërisht pasojë e marrëdhënieve jo të mira në mes të policisë dhe prokurorëve, qështje kjo që do të diskutohet më poshtë. Nevoitet vëmendje e lartë e nivelit të lartë të qeverisë për të ndryshuar zakonet e rrënjësura dhe rivalitetet institucionale dhe për të fuqizuar bashkëpunimin.

<sup>72</sup> Intervistë telefonike e Grupit të Krizave, departamenti financiar i PK-së, 11 maj 2010.

<sup>73</sup> Policët me edukim bazë marrin €503 në muaj, duke u rritur në €888 me trajnime shtesë, në Republika Srpska, në nga dy entitetet e Bosnjës. Komunikim me adresë elektronike me ministrinë e brendshme të këtij shteti, 10, mars 2010.

<sup>74</sup> Policët e kanë të vështirë të prodhojnë informata dhe raporte bazuar në informatat që ofron sistemi. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 6 prill, 2010. Ose shërbyesit policorë nuk janë mjaft të trajnuar apo sistemi nuk është efikas.

<sup>75</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it fq. 37.

<sup>76</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, oficer i PK-së, Prishtinë, 6 prill, 2010.

<sup>77</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it, fq. 37; Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Prishtinë, 24 mars, 2010.

<sup>78</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it fq. 27-28.

<sup>79</sup> Ibid, rekomandimet PSD/2/2009, PSD/7/2009 (“dizajnimin, implementimin dhe vlerësimin e sistemit të përbashkët I mbledhjes së krimeve, investigimit të krimeve dhe statistikave të prokurorisë... duke siguruar marrëveshje lidhur me numrin e përgjithshëm të krimeve, të krimeve serioze (që shqetësojnë qytetarët), sikurse kategorizmin e qartë “e zgjidhur” dhe “e pazgjidhur” për krimet e ndryshme dhe PSD/8/2009, fq. 25, 33-34.

<sup>80</sup> Intervista të Grupit të Krizave, këshilltar i lartë i policisë së EULEX-it, Prishtinë, 30 mars, 2010; prokurori shtetëror i Kosovës, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>81</sup> Policia kufitare shfrytëzojnë sistemin PISCES nga SHBA-të, shtylla operationale sistemin KPIS, një sistem i dobët kurse shtyllat për krimin databazën e tyre. Intervista të Grupit të Krizave, ish-zyrtar i lartë i shtyllës operationale të PK-së, Prishtinë, 27 prill, 2010; zyrtar i procedimit të informatave në shtyllën e krimit, Prishtinë, 23 prill, 2010.

<sup>82</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Aleksandër Lumezi, kryeprokuror, zyra e prokurorit në komunën e Prishtinës, Prishtinë, 13 janar, 2010.

Trajnimet janë zvogëluar dukshëm që nga 2007 kur PK-ja mori përgjegjësisë për këtë nga UNMIK-u. Programet janë parë si shpërblime apo kohë e lirë, kur mbahen në një vende të dëshirueshme, përndryshe shmangen<sup>83</sup> pasi që oficerët nuk shohin asnjë përfitim nga kjo: “Unë nuk marr asgjë nga kjo, asnjë promovim, nuk ka as rritje të pagave”.<sup>84</sup> Shumë komandantë rajonal dhe komandatntë të stacioneve refuzojnë të marrin pjesë në trajimin trejavor për menaxhim të lartë dhe hezitojnë për të dërguar zyrtarët e tyre, pasi ata vazhdimisht ankohen për mungesë të fuqisë punëtore. Një vëzhgues ndërkombëtar vuri në dukje: “Njerëzit sa më lartë që shkojnë, kanë më pak gatishmëri që të jenë të trajnuar”.<sup>85</sup> Oficerë të tjerë ankohen për trajnerë jo të kualifikuar: “Shumë oficerë ndihen të ofenduar të trajnohen nga instruktorë lokal, me sa duket shumë prej instruktorëve kanë kë kryer vetëm shkollat e mesme”.<sup>86</sup>

## A. HETIMET

Shtylla e krimit në kuadër të PK-së në përbërje prej 520 oficerëve është përgjegjëse për të hetuar dhe analizuar krimet e rënda, të tilla si vrasjet, vjedhjet, dhunimet, vjedhjet, terrorizmin, krimin e organizuar, drogën dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Kapaciteti I kësaj shtylle është I pamjaftueshëm për të trajtuar të gjitha këto.<sup>87</sup> UNMIK-u mbajti kontrollin mbi këto detyra deri në verën e vitit 2008. Transferi ishte planifikuar dobët dhe kaotik, dhe UNMIK-u dështoi në trajnimin e zyrtarëve kosovarë në shkathësitë e nevojshme për hetimin e krimeve të rënda. PK-ja e ka riorganizuar këtë shtyllë në vitin 2009, ka krijuar e departamente të reja, ka vënë standarde dhe ka bërë identifikimin e nevojave për trajnim. Janë planifikuar departamente të tjera për vitin 2010, me prioritet mbrojtjen e dëshmitarëve dhe njësitë financiare.<sup>88</sup>

Ka pasur sukses në disa lëmi. Prokurorët e krimeve të luftës të EULEX-it janë të kënaqur me ekipin e hetimit nga PK-ja, të caktuar për t'i ndihmuar ata. Prokurorët e

EULEX-it punojnë shumë ngushtë me policinë në shumicën e rasteve në të cilat prokurorët e EULEX-it kanë juridiksion primar.<sup>89</sup> Detektivët nëpër stacione e kryejnë mire punën dhe kanë filluar t'i ndjekin grupet kriminale aktive në vend që të presin që krimi të ndodhë. Disa njësi të specializuara, siç është njësia e trafikimit njerëzor, janë duke u përmirësuar.<sup>90</sup>

Por shtylla e krimit ka kapacitet të kufizuar për t'u marrë me krime më të rënda se ato të nivelit të ulët, për shkak të ndërhyrjes politike, problemeve të sigurisë dhe trajnimit të kufizuar.<sup>91</sup> Policia ndonjëherë nuk e di se si të kryejë procesin e marrjes në pyetje. Sipas dëshmive anekdotike sugjerohet që disa oficerë të gëzojnë reputacion të frikshëm që është një trashëgimi e sundimit serb; një oficer i tha: “Unë arrestoj autorin e krimit, dhe kolegët e mi e rrahin. Kështu kryhet puna”.<sup>92</sup> Ngannjëherë, prokurorët dyshojnë se policia po bën fshehjen e qëllimshme të provave dhe po saboton prokurorinë. Një prokuror që ka hetuar një zyrtar, një të njohur të afërt të ministrit të punëve të brendshme, tha për Grupin e Krizave se pas marrjes së provave të mjaftueshme për rastin, është kërkuar nga policia që të konfirmojnë rastin. Ata nuk kanë dhënë përgjigje për disa muaj, dhe pastaj kanë deklaruar se nuk kanë gjetur prova që do ta implikonin at individ.<sup>93</sup> Gjithashtu, që nga janari 2009, prokurorët raportojnë që kanë kërkuar nga policia që të hetojë 160 raste të cilat u janë referuar nga agjensia anti-korrupsion dhe kanë marrë përgjegje vetëm për tre ose katër nga këto raste.<sup>94</sup>

Kosova nuk ka kapacitet efektiv të shërbimit të fshehtë për krime. Edhe pse menaxhmenti i lartë i PK-së deklaroi se njësi I inteligjencës është nga më të mirët, EULEX-I bën thirrje për ndryshim themelor “të kulturës së oficerëve të PK-së, që u lejon atyre pjesëmarrje në takimet e inteligjencës, si pjesë e detyrës së tyre themelore”; pajtueshmëria e menaxhimit të shtyllës së krimit.<sup>95</sup> Përveç kësaj, raporti programor i EULEX-it vë në dukje një qëndrim të

<sup>83</sup> Crisis Group intervieuës, Pristina central police station officer, 24 March 2010; former police education consultant, Pristina, 31 March 2010.

<sup>84</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, officer i policisë, stacioni i Prishtinës, 22 shkurt, 2010.

<sup>85</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të OSBE-së, Prishtinë, 22 mars, 2010.

<sup>86</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, ish-trajner i qendrës konsulente, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>87</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i shtyllës së krimit i policisë, 31 mars, 2010; zyrtar i OSBE-së, Prishtinë 22 mars, 2010; zyrtar i BE-së, Prishtinë, 24 mars, 2010, i cili kishte thënë, “UNMIK-u nuk kishte dashur që fjala ‘inteligjencë’ të përdoret në polici.

<sup>88</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë shtyllës së krimit në polici, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>89</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, prokurori i EULEX-it, Prishtinë, janar 2010. “Ligji mbi juridiksionin, zgjedhjen e rasteve dhe alokimin e tyre i gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në”, numër 03/L053, i jep kompetencë të plotë EULEX-it rreth krimeve të luftës dhe krimeve tjera.

<sup>90</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it fq. 38, 43-44.

<sup>91</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar departamenti amerikan i drejtësisë, Prishtinë, 22 mars, 2010.

<sup>92</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, officer i stacioni qëndror të policisë, 22 shkurt, 2010.

<sup>93</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, prokurori, zyra prokurorit shtetëror, Prishtinë, 5 shkurt, 2010.

<sup>94</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Ismet Kabashi, kryeprokuror i Kosovës, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>95</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it, fq.63. Raporti i njejt (fq. 36) se “aftësia e e PK-sw pwr krijimin e planeve tw bazuara nw inteligjencw nga EULEX-i wshtw konsideruar si shumw e dobtw”.



kufizuar për sa I përket intelgjencës dhe informacioneve: “Çdo njësi, ekip, dhe stacion run korpusin e vet të zbulimit dhe e sheh e rolin e saj si në konkurrencë me pjesët e tjera të organizatës”. Midis hetuesve penal në nivel stacioni, “inteligjenca ka tendencë të komunikon me gojë dhe i mungon struktura dhe metodologjia”, dhe askush nuk duket të ket aftësi për zotëruar bazat e trajtimit të intelgjencës kriminale.<sup>96</sup>

Menaxhmenti I shtyllës së krimit është i vetëdijshëm për mangësitë kryesore dhe është duke kërkuar për t’u përmirësuar<sup>97</sup>, por përpjekjet për të promovuar punë policore të udhëhequr nga intelgjencia, që nga viti 2007 kanë dështuar. E shtyrë nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) dhe donatorë relavant, policia zyrtarisht filloi një projekt të ri në fund të vitit 2009, duke emëruar udhëheqësin e shtyllës së krimit e poashtu edhe duke bërë ristrukturimin e saj. Kjo nismë është financuar nga Programi I Instrumentit të Komisionit të BE-së për ndihmë të para-pranimit (IPP).<sup>98</sup>

## B. OPERACIONET

Shtylla e operacioneve, deri tani komponenta më e madhe të PK-së, është fytyra publike e policisë. Oficerët e saj të uniformuar janë përgjegjës për çështjet e përditshme që I sjellin ata në kontakt të shpeshtë me qytetarët, si zbatimi i kontrollit në trafik, patrullat dhe detyra të tjera. Përderisa puna e tyre është më pak e dukshme se sa ajo e kolegëve të cilët merren me krimet e rënda, kjo është ndoshta më e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës. Besimi në polici varet më shumë në çështjet relativisht të vogla, sepse ato drejtpërdrejt dhe menjëherë të ndikojë te numër I madh I njerëzve. Dhe pa besimin popullor, aftësitë e PK-së për të hetuar krimin e rëndë dhe të organizuar do të jenë të kufizuar.<sup>99</sup>

EULEX-it ka gjetur se “rastet e veprimeve tw duhura prej mbikqyrwsvve tw patrullave janw shumw tw mw tw vogla se ato ku wshtw treguar dobwsi”. Menaxhmenti është veçanërisht i dobët, duke i lënë oficerët e patrullave “me pak apo aspka mbikqyrje nga ana e erporëve të tyre”. Është brengosës fakti që, “në vend të forcimit të zbatueshmërisë së ligjit për trafikun zbatueshmëria e ligjit varet shumë nga casja individuale e policit dhe shumë policë të patrullave tentojnë ta imponojnë politikën e tyre – bazuar në perceptimet e pasurisë relative të shoferëve – të bëjnë vënien e biletave të dënimit”. EULEX-it gjithashtu rapor-

tuan se drejtorja e operacioneve ishte “e dobët” në shumë fusha, duke përfshirë planifikimin dhe aspekte të shumta të menaxhimit.<sup>100</sup>

Si në shumë vende, aksidentet në trafik marrin më shumë jetë se sa vrasjet, 41 vetë vdiqën në aksidentet e automjeteve në tre muajt e parë të vitit 2010. Shtylla e operacioneve e ka bërë vënë sigurinë në komunikacionin si prioritet të lartë për vitin 2010, dhe zyrtarët e saj janë të trajnuar mirë dhe të aftë. Megjithatë, bashkërendimi i varfër me juridiksionin, në këtë rast gjykatat që merren me vepra të vogla, kufizon rezultatet e punës së policisë. Në teori, shoferët që kryejnë shkelje të rënda tri herë humbasin licencën për vozitje, por policia nuk ka një sistem që mbanë informatat për shkelësit e përsëritur të rregullave të trafikut. Kjo ka mbetur si detyrë e gjykatës për kundërvajtje, e cila nuk arrin të mbajë të dhënat e shkeljeve serioze të trafikut dhe, për më tepër, nuk I raporton ato në polici.

Dyshimi midis policisë dhe gjykatës ka shtyrë komandantin rajonal të Prishtinës të urdhërojë oficerët e tij të trafikut të shkruajnë gjobat në vend të ngjarjes, në vend që shkelësi të thirret që të paraqitet në gjykatë, që zakonisht kërkohet nga qytetarët, pasi kjo u lejon atyre të negociojnë me gjyqtarët dhe të paguajnë një gjobë më të vogël ose t’I shmangen tërësisht asaj.<sup>101</sup> Policët nuk I respektojnë as gjykatat; njëri tha për Grupin e Krizave se ai kishte “more than tëenty summons in my pocket” për kundërvajtje të vogla në trafik. Pa policinë, gjyqtari është i detyruar për të shkarkuar një rast.<sup>102</sup>

Patrullat e trafikut shpesh përfitojnë nga mbikëqyrja joadekuate. Një turn në njësinë e trafikut është, për shumë oficerë, një ditë relaksuese jasht.<sup>103</sup> Në përgjithësi, njësia e trafikut është e njohur për mosmarrje të rryshfetit, edhe pse disa oficerë të sillen në mënyrë kapriçioze, dhe një komandanti i policisë beson se rastet e kërkesave të jashtligjme janë në rritje sidomos të huajve.<sup>104</sup> Policia në rajonin e Mitrovicës ankohet se një numër I madh I policëve nga njësitë e trafikut local, së bashku me shumë nga njësi të veçanta, janë të përfshirë në kontrabandë.<sup>105</sup>

<sup>96</sup> Ibid, fq. 36, 39.

<sup>97</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Kadri Arifi, ndihmësdrejtor, Kadri Arifi, ndihmësdrejtor i policisë për hulumtimin e krimeve, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>98</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, 24 mars, 2010.

<sup>99</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i policisë së EULEX-it, 15 mars, 2010.

<sup>100</sup> Raportit i Programeve i EULEX-it, fq. 45-46.

<sup>101</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Emin Beqiri, drejtor, Drejtorati rajonal i Prishtinës, Prishtinë, 17 mars, 2010.

<sup>102</sup> “Ata dërgojnë dy apo tri rezyme, dhe pasi që gjyqtari kupton se policia nuk do të vijë, ai thjesht e lë pas dore rastin”. Intervistë e Grupit të Krizave, oficer i stacionit qendror të policisë në Prishtinë, 25 shkurt, 2010.

<sup>103</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, oficer i stacionit qendror të policisë në prishtinë, 22 shkurt, 2010.

<sup>104</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i shtyllës së krimit në polici, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>105</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, oficer i PK-së, Mitrovicë, 20 janar, 2010.



Janë vënë re mangësi të mëdha në menaxhimin e asetëve të policisë, mjeteve dhe automjeteve. IPK ka vërejtur se policia është fajtores në më shumë se gjysmën e të gjitha aksidentëve të trafikut në të cilat janë përfshirë automjetet e tyre, dhe rrallë herë këto incidente janë shkaktuar për shkak të ndonjë rasti ndjekjeje të shpejt të ndonjë të dyshuari. Prokurimit është në gjindje kaotike: policisë I mungojnë kategori e rëndësishme e pajisjeve, por shpenzon para për ekstravaganca të panevojshme; një ekspert ndërkombëtar u ankua se Kosova blen automjete Volksagen Golf, ndërkohë që policia gjermane kënaqen me Shkoda.<sup>106</sup>

### C. SHPËRDORIMET E BRENDSHME DHE KRIMET

Shpërdorimet e bëra brenda policisë trajtohen nga dy njësi: IPK punon me rastet e rënda, Njësia e Brendshme e Hetimeve (NBH) merret me akuza më të vogla. IPK-ja është organ i pavarur, që i raporton Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka për detyrë të bëjë hetimin e ankesave për shkelje të rënda të policisë, të tilla si përdorimi I tepërt I forcës<sup>107</sup>, inspektion dhe analizon punën e policisë dhe sugjeron përmirësime. Staf i këtij organi është I pamajftueshëm, nuk përkrahet dhe I pasigurtë për mandatin dhe formën që do ta ket në të ardhmen. Një oficer i lartë në NBH tha për Grupin e Krizave se “pa asnjë dyshim” menaxhmenti i lartë nuk e ka mbështetur e as nuk e ka kuptuar këtë departament.<sup>108</sup> Menaxhmenti I policisë e konsideron NBH-në si staf administrativ, kategori kjo e përjashtuara kryesisht nga ngritja e pagave që është bërë kohëve të fundit – një shenjë kjo e neglizhencës dhe një pengesë për mbajtjen e hetuesve të mirë.<sup>109</sup> Kjo pabarazi është e pajustificueshme dhe duhet të eliminohet. Sipas një ligji i ri, I cili është draftuar, do të bëhet rritja e kompetencave të IPK-së duke I dhënë autoritet për të hetuar krimet (dhe jo thjesht shpërdorimet e vogla) e kryera nga policia, dhe në të njëjtën kohë komandantëve të stacioneve do tu ipet autoritet më i madh për të mbajtur disiplinë dhe rregull.

IPK ka qenë pa drejtor për një vit, sepse organi i ngarkuar me emërimin e drejtorit - Këshilli Qeveritar për Emërimet

të Larta, i kryesuar nga kryeministri - nuk është takuar që nga pavarësia. Këtu nuk ka as person të ngarkuar me punët e drejtorit; zyrtari më i lartë është shefi i hetimeve, Valdet Hoxha, por ministria e punëve të brendshme e ka autorizuar atë të veprojë si drejtor vetëm kur ka të bëjë me hetimet, dhe jo për detyra të tjera të IPK-së, e sidomos jo për monitorimin e performacës së policisë.<sup>110</sup> Cilado qoftë arsyeja për vonesën, është krijuar një përshtypje se qeveria nuk qëndron prapa IPK-së apo mandatit të saj. Gjithashtu, ministrisë së punëve të brendshme iu deshën disa muaj për krijimin Komisionit për Emërimet të Larta dhe Masa Disiplinore (KELMD), dhe paneli për dëgjimin e rasteve disiplinore nuk është krijuar deri në janar 2009.

Spektori I hetimeve i IPK-së ka pesëmbëdhjetë hetues, dhe vetëm njëri prej tyre është një ish-oficer i policisë, për pjesën tjetër, kërkesat për praninë ishin modeste: një diplomë universitare dhe trajnime në fushën e ligjit dhe të menaxhimit.<sup>111</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), beson se stafi është profesional, i trajnuar mirë dhe bën raporte shumë të mira.<sup>112</sup> Por përdorimi menaxhmenti I policisë pretendon të aplikojë politikën për “zero tolerancë” për krimin brenda organizatës,<sup>113</sup> sistemi nuk është mjaft efektiv, dhe vetëm disa oficerë përballesh me masat disiplinore. IPK kishte rreth 1700 raste në vitin 2009 dhe 2024 në vitin 2008 (në rreth 300 prej të cilave përfshihen serbët që u larguan nga puna pas pavarësisë); kapacitetin e saj ekzistues mundëson hetimin e vetëm përafërsisht 400 ankesa gjatë tërë një viti.<sup>114</sup>

Nga 866 raste më pak serioze të hetuara nga NBH-ja në vitin 2009, 773 janë përfunduar, dhe për 593 prej tyre janë theksuar dënime disiplinore, duke përfshirë katër diskualifikime.<sup>115</sup> Pothuajse asnjë nga ankesat e qytetarëve, rreth 218 sosh, nuk kanë rezultuar me masa disiplinore ndaj oficerëve dhe më tepër se gjysma e këtyre rasteve janë

<sup>106</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të OSBE-së, 22 mars, 2010.

<sup>107</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Zenun Pajaziti, ministër i punëve të brendshme, Prishtinë, 12 mars, 2010; Valdet Hoxha, kryesues i departamentit të hulumtimeve, inspektorati policor, 15 mars, 2010.

<sup>108</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 16 mars, 2010.

<sup>109</sup> Hulumtues të brendshëm marrin pagat më të ulëta në polici, rreth €320; të gjithë hulumtuesit tjerë marrin nga €395; Intervista të telefonike të Grupit të Krizave, departamenti i financave i PK-së, 11 maj, 2010; dhe zyrtar i lartë i PK-së IIU, Prishtinë, 15 mars, 2010.

<sup>110</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i inspektoratit të policisë, Prishtinë, 15 mars, 2010.

<sup>111</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Valdet Hoxha, kryesues i departamentit të hulumtimeve, inspektorati i policisë, Prishtinë, 15 mars, 2010.

<sup>112</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, konsulent ndërkombëtar, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>113</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të PK-së, Prishtinë, 5 mars, 2010.

<sup>114</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Valdet Hoxha, kryesues i departamentit të hulumtimeve, inspektorati i policisë, Prishtinë, 15 mars, 2010.

<sup>115</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, departamenti i hulumtimeve të brendshme, PK, Prishtinë, 16 mars, 2010. Aksioni përfshinte 12 lajmërimet serioze; 43 suspendime me pagesë; 9 tranfere disiplinore; 102 lajmërimet me shkrim; 16 dënime dhe 408 lajmërimet verbale; 127 raste janë kthyer në PIK për hulumtime të metutjeshme; në pesë raste nuk është ndër-marrë asgjë.

mbyllur dhe konsideruara si “të pabaza”.<sup>116</sup> Zakonisht, nuk ka dëshmitarë gjatë shpërdorimeve të detyrës nga ana e policisë, të pranishëm janë vetëm policia dhe qytetari, dhe oficerët kanë për tendencë të mbështesin njëri tjetrin. Ka pasur edhe raste kur dëshmitarët I kanë tërhequr deklaratat e tyre apo I kanë ndryshuar tërësisht ato, me sa duket për shkak të presionit nga policia.<sup>117</sup> Megjithatë, kreu i INBH-së tha se procesi i hetimit i dërgon një mesazh të qartë policit që bën thyerjen e rregullave, edhe nëse nuk ipet një rezultat zyrtar.<sup>118</sup>

Policia ka ndërmarrë masa ndaj disa zyrtarëve të korrup-tuar. Një hetues i rajonit të Pejës u arrestua në janar të vitit 2010 për marrje të mitos në shumën prej 10.000 € nga familja e një viktime të një vrasjeje – gjoja për t’i përdorur për t’u paguar mito dëshmitarëve të tjerë të cilët siaps tij nevojteshin për këtë rast.<sup>119</sup> Në fund të marsit të vitit 2010, policia arrestoi dy oficerë për shpërndarjen e informacionit në lidhje me përgjimin e telefonit të një të dyshuari.<sup>120</sup> Në tetor 2009, ata arrestuan dymbëdhjetë policinë kufitare për marrje të mitos, dhe EULEX-I ka sygjeruar që policia kufitare të mos mbajë telefona celularë në punë, për të parandaluar koordinimin e tyre me kontrabandistët.<sup>121</sup> Ndërkohë që masa të tilla të forta, mund të sinjalizojë se menaxhmenti ka nisur të marrë seriozisht korrupsionin e policisë, deri më tani ata duket të jenë përjashtim nga rregulli.

Ekzistojnë akuza të besueshme se oficerë individual janë të përfshirë në krime serioze të cilat kërkojnë hetime të mëtejshme dhe ndjekje të mundshme penale. Megjithatë, policia nuk janë kooperativë në rastet në të cilat anëtarët e tyre janë të përfshirë. Prokurori, kur bën thirrje për asistencë nuk e din se a ka të bëjë me bashkë-autorë apo oficerë të ndershëm.<sup>122</sup> Lidhjet e oficerëve me trafikimin e qenieve njerëzore dhe të prostitucionin mendohet se paraqet një problem serioz: disa raste kanë të bëjnë me disa veprimtari tashmë të zbuluara, dhe ka edhe të tjerë të dyshuar.<sup>123</sup> Konsulentë ndërkombëtarë kanë ngritur dyshi-

met për përfshirje të policisë në mbrojtjen e kriminelëve.<sup>124</sup> Oficerët e policisë të cilët kanë folur për Grupin e Krizave kanë thënë se grupe brenda policisë mund të ndihmojnë shpërndarjen e drogës në Prishtinë, edhe pse kjo mund të ndryshojë me arrestimet e dilerëve të cilët më parë kanë qenë të mbrojtur.<sup>125</sup>

Zgjerimi I parashikuar i autoritetit të IPK-së është kontrovers, pjesërisht për shkak se për dallim nga policia, IPK është nën autoritetin e ministrisë së punëve të brendshme dhe të qeverisë. Disa, duke përfshirë OSBE-në, frikësohen se kjo do të jetë një hap drejt krijimit të një “policie speciale”, me kompetenca të plota, duke përfshirë të drejtën për mbajtjen e armëve të zjarrit, por nën kontrollin politik.<sup>126</sup> Përderisa OSBE-ja mbështet hetimin e veprave penale të policisë nga IPK, me kusht që të bëhet trajnimi duhur, ajo kundërshton hetimeve e shkeljeve të rënda disiplinore nga NBH-ja.<sup>127</sup> Njësia e hetimeve e IPK-së pritet të rrisë stafin e saj për 60 deri në 80 stafi të ri.<sup>128</sup> Dhënia e fuqisë komandantëve të stacioneve për të zgjidhur rastet e vogla është më pak kontraverzale, dhe mund të rrisë përgjegjësinë dhe mirëqenjen e tyre.<sup>129</sup> Por duhet më shumë se kjo për të bindur menaxhmentin e lartë për vlerën reale të hetimeve të brendshme.<sup>130</sup>

Megjithëse të dyja kanë nevojë të madhe për ndihmë teknike dhe mbështetje politike, EULEX-i nuk u jep mbështetje as IPK e as Njësisë së Brendshme të Hetimeve.<sup>131</sup> Përveç informatave të marra nga Veriu dhe ndonjë vizite protokolare të rastit, kontaktet janë të pakta. EULEX-i duhet ta ket me prioritet të lartë sigurimin e ndihmës për IPK-në që të bëhet pjesë e integruar mirë e sistemit të policisë së Kosovës.

<sup>116</sup> Ibid. Ankesat kryesore të qytetarëve trajtoheshin pa dinjitet; 648 nga 866 rastet vinin nga menaxhmenti.

<sup>117</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i hulumtimeve në PIK, Prishtinë, 15 mars, 2010.

<sup>118</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, PK IIU, Prishtinë, 16 mars, 2010.

<sup>119</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, prokuror, zyra e prokurorit special, Prishtinë, 4 shkurt, 2010.

<sup>120</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i PK-së për informim publik, Prishtinë, 6 prill, 2010.

<sup>121</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë të PK-së, Prishtinë, 5 mars, 2010; zyrtar i lartë, EULEX, departamenti i forcimit të policisë, Prishtinë, 16 mars, 2010.

<sup>122</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, prokuror, zyra e prokurorit special, Prishtinë, 4 shkurt, 2010.

<sup>123</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Prishtinë, 24 mars, 2010; prokuror, Prishtinë, prill, 2010.

<sup>124</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të departamentit amerikan të drejtësisë, Prishtinë, 22 mars, 2010.

<sup>125</sup> Intervista të Grupit të Krizave, oficerë të tanishëm dhe të kaluar të PK-së, Prishtinë, prill dhe maj, 2010.

<sup>126</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë, departamenti i sigurisë publike të OSBE-së, Prishtinë, 15 dhe 22 mars, 2010.

<sup>127</sup> Korespondence me postë elektronike e Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë, departamenti i sigurisë publike të OSBE-së, Prishtinë, 15 maj, 2010.

<sup>128</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Valdet Hoxha, kryesues i departamentit të hulumtimeve, inspektorati i policisë, Prishtinë, 15 mars, 2010.

<sup>129</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Emin Beqiri, komandanti rajonal i PK-së, 17 mars, 2010; zyrtarë të lartë, departamenti i sigurisë publike të OSBE-së, Prishtinë, 22 mars, 2010.

<sup>130</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë, departamenti i hulumtimeve të brendshme, SHPK, Prishtinë, 16 mars, 2010; zyrtarë të lartë, departamenti i sigurisë publike të OSBE-së, Prishtinë, 22 mars, 2010.

<sup>131</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i inspektoratit policor, Prishtinë, 15 mars, 2010.

### III. GJYQËSORI

Sistemi gjyqësor i Kosovës është përkeqësuar deri në atë masë sa që, shumica e qytetarëve nuk e kanë mundësinë për t'iu çasur drejtësisë. Problemet janë akumuluar nën mandatin e UNMIK-ut, dhe ka pasur pak ndryshime pas pavarësisë dhe pas vendosjes së EULEX-it. Kosova ka një numër shumë të vogël të gjyqtarëve dhe prokurorëve; ata që janë paguhen shumë dobët dhe nuk kanë kurrfarë prestigji apo autoriteti shoqëror, janë të demoralizuar dhe shumë pak të trajnuar. Korniza ligjore është një përzierje konfuzeve e ligjeve të vjetra të Jugosllavize, ligjeve të UNMIK-ut dhe legjislacionit të ri të Kosovës. Nuk ka menaxhimin apo mbikqyrje efektive; gjyqtarë dhe prokurorë punojnë si të munden, në objekte të papërshtatshme dhe pa ndihmë apo mbojtje në rast nevojë.<sup>132</sup> Mekanizmat anti-korrupsion janë në vend dhe operative, por të paefektshëm, bllokuar nga mungesa e mbështetjes politike dhe lidshiptit. Së fundi, ekzistojnë sfidat për qështje të sigurisë, sidomos në rastet e rënda penale, ku dëshmitarët përballen me frikësime apo edhe më keq dhe shpesh nuk janë të gatshëm të dëshmojnë.

Krimet e dhunshme janë relativisht të rralla, dhe gjyqësorit, i dobët siç është, ka mundësi t'i trajtojë rastet penale. Por sistemi joefektiv i ligjit civil, e cila përfshin kryesisht mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me pronën dhe privatizimin e mbanë shoqërinë, ekonominë dhe vet qeverinë të çrregullt dhe të hapur ndaj abuzimeve.<sup>133</sup> Në disa raste, këto mosmarrëveshje – në mungesë të mjeteve efektive ligjore – krijojnë dhunë; prokurorët ndërkombëtarë besojnë se shumë raste të vrasjeve e kanë zanafillën të konfliktet për pronë.<sup>134</sup>

Korniza ligjore ka shumë nevojë për azhurnim. Katër ligjet kryesore – që kanë të bëjnë me gjykatat, Këshillin Gjyqësor, shërbimin e prokurorisë dhe Këshillin Prokurorial – janë shtyrë, njëri prej tyre, ligji mbi gjykatat, ka kaluar pothuajse nëpër 50 projekt-ligje nga viti 2004. Qeveria fajësoi për vonesën mosmarrëveshjet në mes të ndërkombëtarëve, sidomos ZNKE-në dhe USAID-in.<sup>135</sup> Ndërsa zyrtarë të USAID-it e mohojnë këtë, ata pranojnë që diskutimet kanë qenë “të gjera dhe të lodhshme” dhe kanë përshkruar procesin në të cilin qeveria ka qenë më shumë një klient për të miratuar pakon e fundit se sa një

pjesëmarrës aktiv i formësimit të asaj pakoje.<sup>136</sup> Një zyrtar i lartë i ZNKE-së përshkroi procesin e hartimit si një bashkëpunim midis ZNKE-së, USAID-i dhe Zyres Civile Ndërkombëtare (ZCN), me të dhëna të rastit të siguruara nga EULEX-i, dhe theksoi nevojën për të harmonizuar qëndrimet ndërkombëtare.<sup>137</sup>

Ligji mbi gjykatat e kaluar leximin e parë në Kuvend më 15 prill 2010; miratimi apo I të katër ligjeve duhet të jetë prioritet i lartë. Gjithashtu, Kodi i Procedurës Penale, i hartuar nga UNMIK-u, të cilin një gjykatës me përvojë e përshkroi si “të shkruar nga njerëz që kurrë nuk kanë parë një gjykim në gjykatë”, dhe Kodi civil për Procedurën Kontestimore kanë nevojë urgjente për ndryshim.<sup>138</sup> Qeveria duhet të marrë rolin udhëheqës në ndryshimin e legjislacionit, në koordinimin dhe udhëzimin e dhënave të marra nga ndërkombëtarët e jo thjesht ta bëjë miratimin e një produkti final.

#### A. GJYKATAT

Për një vend të vogël, Kosova ka një mori gjykatash: kushtetuese, supreme dhe komerciale, të gjitha me juridiksion në mbarë vendin dhe me seli në Prishtinë, pesë gjykata të qarkut (Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren), dhe 24 gjykata komunale, plus gjykatat për kundërvajtje (shkelje).<sup>139</sup> Një ligj për reformimin e gjykatave

<sup>136</sup> Së fundmi mosmarrëveshja është fokusuar rreth asaj se si të mirëmbahet plani i Ahtisaarit dhe mbrojtja e interesave të komuniteteve jo-shumicë në sistemin e ri gjyqësor. (Plani i Ahtisaarit, plan i mandatuar nga OKB-ja për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, kishte paraparë periudhën e mbikqyrjes së pavarësisë. Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 182, *Kosova: Plani i Ahtisaarit nuk ka konkurrencë*, 14 maj, 2007.) Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i USAID-it, Prishtinë, 17 mars, 2010. USAID-i kishte thënë se “nuk ka mosmarrëveshje” mes SHBA-së dhe BE-së mbi draft ligjin e gjykatave që tani mbështetet nga “të gjitha palët [ndërkombëtare dhe lokale]”; korrespondence me poste elektronike e Grupit të Krizave, USAID Prishtinë, 11 maj, 2010. Një zyrtar i lartë i SHBA-së ka thënë se ankesa e qeverisë kishte bazë rreth mosmarrëveshjes mes SHBA-së dhe ECLO-së që kishte vonuar procesin; intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 12 mars, 2010.

<sup>137</sup> Intervistë e Grupit të Krizave dhe korrespondence me postë elektronike, zyrtar i ECLO-së, Prishtinë, 8 dhjetor, 2009 dhe 17 maj, 2010.

<sup>138</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, gjyqtar i EULEX-it, Gjykata e Qarkut e Prishtinës, 3 shkurt, 2010. Intervistë e Grupit të Krizave, gjykatës i Gjykatës Supreme, dhe prokuror i EULEX-it, Prishtinë, 29 janar, 2010; zyrtarë i PK-së, Prishtinë, 5 mars, 2010; Prokurori shtetëror i Kosovës, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>139</sup> 24 gjykata komunale, dy prej të cilave (Prishtinë dhe Ferizaj), kanë degë në enklavat e afërme serbe, në Graçanicë dhe Shtërrpce, bëjnë dëgjimin e mosmarrëveshjeve civile, dhe rastet që përfshijnë krime me dënime prej tri vjet apo më pak; tri gjykata komunale në veriun e Kosovës (Mitrovicë, Leposaviç dhe Zubin Potok) nuk funksionojnë, dhe serbët përdorin “gjy-

<sup>132</sup> “Intimidimi i Gjyqësorit; Siguria e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, departamenti i komuniteteve dhe të drejtave të njeriut të OSBE-së, botimi tretë, prill, 2010.

<sup>133</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, anëtar i KJC-së, Prishtinë, 25 janar, 2010.

<sup>134</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, prokuror i EULEX-it, Prishtinë, 29 janar, 2010.

<sup>135</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Hajredin Kuçi, zëvendës kryeministër, Prishtinë, 7 dhjetor, 2009.

duhet të thjeshtësojë dhe të zvogëlojë këtë strukturë, por sic është hartuar deri më tani, nuk do të hyjnë në fuqi deri në vitin 2013.<sup>140</sup> Të gjitha gjykatat dëgjojnë raste civile dhe penale, gjykatat komunale dëgjojnë raste penale me dënime deri në tre vjet burg, ndërsa gjykatat e qarkut dëgjojnë raste më të rënda penale, si dhe ankesat ndaj vendimeve gjyqësore në gjykatën komunale. Përderisa numri i gjykatave është mjaft i madh, numri i gjyqtarëve është relativisht i vogël dhe ka shumë pak qasje efektive në drejtësi. Asnjë gjyqtar i ri nuk është emëruar që nga ditët e hershme të UNMIK-ut, kur emërimi ishte e kufizuar në juristë që kishin punuar para goditjes serbe të vitit 1990.<sup>141</sup> Mosha mesatare e gjyqtarëve është 54 vjet, dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre janë nën moshën 40 vjeçare.<sup>142</sup> Duke pasur parasysh që 57 përqind e qytetarëve janë nën moshën 25 vjeçare – fakt ky që e bën Kosovën ndër vendet me popullsi më të re në Evropë, – ekziston një ndryshim i madh ndërmjet kësaj gjenerate dhe të moshuarve të edukuar nga Serbia të cilët i gjykojnë ata.<sup>143</sup> Shoqata e gjyqësorit me kohën e sundimit serb e dobëson autoritetin e saj moral.

Që nga viti 2008, të gjithë gjyqtarët (dhe prokurorët) në fuqi, është dashur të riaplikojnë për punët e tyre në një organ ndërkombëtar, Këshillin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP). Verifikimi ka qenë i ngadalshëm<sup>144</sup>. KPGJP-ja ka përfunduar aprovimin e anëtarëve për Gjykatën e Lartë dhe për Zyren e Prokurorit shtetror në fillim të vitit 2010; veprimtaria për shumicën e gjykatave dhe në zyret e prokurorive në nivele rajonale dhe në gjykatat komunale është htyrë për në verë dhe vjeshtë<sup>145</sup>

katat” komunale serbe që mbajnë dënime në apartamentet e gjyqtarëve.

<sup>140</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, konsulent ndërkombëtar, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Pishinë, 4 shkurt, 2010.

<sup>141</sup> Prej vitit 1990 deri në vitin 1999, shqiptarët e Kosovës ishin përjashtuar nga fakulteti juridik i Prishtinës dhe kishin vijuar një fakultet paralel jozyrtar, diplomat e të cilin nuk njiheshin nga UNMIK-u; nga viti 2000, UNMIK-u dhe qeveria e Kosovës kanë dështuar organizojnë provimet e judikaturës; shih poshtë për ministrinë e drejtësisë; gjithashtu “Monitorimi i Gykatave”, BIRN, fq.11.

<sup>142</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it, fq. 85.

<sup>143</sup> “Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan”, op. cit., fq. 24.

<sup>144</sup> Rekomandimet e IJP-së së pari shkojnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), të cilat mund të shtojnë apo të largojnë kandidatë ose thjesht ta vonojnë aprovimin; nga aty, i drejtohen presidentit Fatmir Sejdiu, i cili mund të zgjedhë nëse, dhe kur, t’i caktojë nëpër detyra. i ishin dashur dy muaj për t’i caktuar gjyqtarët e rrethit të pare; zyrtarët evropianë besojnë se kjo është bërë me qëllim të vonimit të votimit. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar evropian, Prishtinë, 24 mars, 2010.

<sup>145</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Peter Bach, drejtori i sekretariatit, Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, Prishtinë, 26 janar, 2010. KPGJP-ja i kishte dërguar rekomandimet e saja për gjykatat komuanle të Prishtinës dhe Mitrovicës, Gjykata për kundërvajtje minore dhe gjykatës komerciale dhe në KGJK-së

Një vendim i hershëm për të filluar procesin me një shkrim provim etike me shkrim, në të cilin shumica kanë dështuar, tregon se rreth një e katërta e aplikantëve është ende në venet e punës, por janë të vetëdijshëm se nuk do të rriemërohen. Është e kuptueshme që këta gjyqtarë janë të demotivuar.<sup>146</sup>

Zyrtarisht, Kosova ka 269 gjyqtarë – ndërmjet 12,2 dhe 14,9 gjyqtarë për çdo 100,000 banorë.<sup>147</sup> Por vetëm 176 prej tyre në të vërtetë kanë dëgjuar raste gjatë vitit 2009, pjesa tjetër janë në letër, por janë joaktiv.<sup>148</sup> Në praktikë, ka ndërmjet tetë dhe 9,8 gjyqtarë që punojnë për çdo 100,000 banorë. Për krahasim, Bosnje-Hercegovina ka 22,1, 40,1 Kroacia dhe Mali I Zi ka 51 gjyqtarë në 100,000 banorë, dhe shumica e vendeve të tjera evropiane kanë gjithashtu shumë më shumë personel. Edhe rritja e planifikuar në 392 gjyqtarë do të linte Kosova mbarpa fqinjëve të saj, me ndërmjet 17,8 dhe 21,8 gjyqtarëve në 100,000 banorë.<sup>149</sup>

Pagat e gjyqësorit janë shumë më e ulëta se në vendet fqinje dhe se ato të zyrtarëve të krahasueshem që punojnë në degët legjislative dhe ekzekutive të qeverisë: gjyqtarët dhe prokurorët të lartë kanë paga me vlerë rreth 600 € në muaj. Pagesa e ulët është interpretuar nga shumica si një shprehje pikëpamjes së qeverisë dhe të shoqërisë për vlerën e punës të gjykatësve dhe statusin e tyre dhe po çon shumë juristë të mirë drejt praktikës private.<sup>150</sup> Kjo gjithashtu i bën gjyqtarëve të ndikueshëm ndaj korrupsionit, i cili mund të paraqitet në forma të ndryshme: si ofertë për punësim të të afërmeve dhe ndihmë në marrjen e një kredie bankare, si zgjidhje e çështjeve të pronës ose të kalimit të testeve, si dhe mito të drejtpërdrejta.<sup>151</sup>

Rritja e pagave për t’i përputhur me ato të zyrtarëve të krahasueshëm shtetëror do të ishte e lirë: dyfishimi i pagës së 400 gjyqtarëve, do t’i kushtonte buxhetit të

në prill; më 11 maj, 2010, rekomandimet ishin me presidentin Sejdiu; korrespondence e Grupit të Krizave me postë elektronike, Peter Bach, drejtor i sekretariatit të KPGJP-së, Prishtinë, 11 maj, 2010.

<sup>146</sup> Intervista të Grupit të Krizave, gjykatës, prokurorë dhe KGJK-ja, dhjetor, 2009-prill, 2010; zyra statistikore e KGJK-së ka vërejtur një rënie në performancën e gjyqtarëve që kishin dështuar në provimin e etikës. Në qershor, 2009, një gjykatës në jug të Kosovës i kishtë ofruar Grupit të Krizave qasje të papenguar në arkivat e gjykatave në këmbim të “ndihmës” për kalimin e provimit të provimit të etikës, të cilin nuk e kishte kaluar.

<sup>147</sup> Raportit i Programeve i EULEX-it, fq. 88.

<sup>148</sup> “Raporti për 2009: Statistikat për Gjykatat e Rregullta”, KGJK, fq. 2.

<sup>149</sup> Raportit i Programeve i EULEX-it, fq. 88.

<sup>150</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Nuhi Uka, president, Gjykata Komunale e Prishtinës, 27 janar, 2010.

<sup>151</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, zyra e këshilltarit disiplinor, KGJK-ja, Prishtinë, 19 janar, 2010.

shtetit rreth €3 milion në vit.<sup>152</sup> Sipas draft ligjit të ri mbi gjykata, kryetari i Gjykatës Supreme do të mirrte pagën e njëjtë si kryeministëri (aktualisht 1,443 € në muaj), një gjyqtar në Gjykatën e re të Apelit do të kishte pagën sa 90 përqind e pagës së një ministri (€ 1,143) dhe një gjyqtar në një gjykatë themelore (që do të zëvendësonte gjykatat e qarkut dhe komunale) do të fitojnë rreth 800 €. <sup>153</sup> Megjithatë drafti shtyen zbatimin e përfitimeve dhe të pagave të reja deri pas strukturimit të gjykatës, që mendohet të bëhet në vitin 2013. <sup>154</sup> Kjo vonesë është e padrejtë dhe e dëmshme, rritja e pagave duhet të zbatohet menjëherë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e verifikuar.

Një pjesë e madhe e rasteve të lëna pas dore, disa prej të cilave datojnë qysh nga vitit 1990, tregojnë për dështimin e drejtësisë. Numri i saktë i këtyre rasteve nuk dihet as në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), i cili raporton për një numër në mes 213,967 e deri në 300,000 raste të papërfunduara. <sup>155</sup> Shumica janë të nivelit komunal, dhe kryesisht raste të ashtuquajtura raste ekzekutive, ku vendimi është marrë por palët kërkojnë procedim të ri, për shembull për të larguar banorin me qera apo për të rikthyer pronën. Vendimet ekzekutive duhet tu japin gjykimeve efektin e botës reale. Shumë prej tyre janë triviale – mospagesa e faturave nga mijëra njerës bllokun sistemin – por tjerat janë më serioze, <sup>156</sup> dhe ato janë duke u proceduar shumë shpejtë duke I pamundësuar gjykatës ta kryejë dëgjimin. Edhe nëse nuk do të kishte asnjë rast tjetër të ri, do të duheshin më shumë se 8 vite që të procedohen të gjitha rastet, me ritmin e tanishëm. Rastet tjera civile janë po aq të këqija, me një grumbullim më të gjatë se pesëvjeçar. Rastet e krimeve kanë një grumbullim prej 30 muajsh. <sup>157</sup>

Një pjesë e madhe e rasteve të lëna pas dore, disa prej të cilave datojnë qysh nga vitit 1990, tregojnë për dështimin

e drejtësisë. Numri i saktë i këtyre rasteve nuk dihet as në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), i cili raporton për një numër në mes 213,967 e deri në 300,000 raste të papërfunduara. Shumica janë të nivelit komunal, dhe kryesisht raste të ashtuquajtura raste ekzekutive, ku vendimi është marrë por palët kërkojnë procedim të ri, për shembull për të larguar banorin me qera apo për të rikthyer pronën. Vendimet ekzekutive duhet tu japin gjykimeve efektin e botës reale. Shumë prej tyre janë triviale – mospagesa e faturave nga mijëra njerës bllokun sistemin – por tjerat janë më serioze, dhe ato janë duke u proceduar shumë shpejtë duke I pamundësuar gjykatës ta kryejë dëgjimin. Edhe nëse nuk do të kishte asnjë rast tjetër të ri, do të duheshin më shumë se 8 vite që të procedohen të gjitha rastet, me ritmin e tanishëm. Rastet tjera civile janë po aq të këqija, me një grumbullim më të gjatë se pesëvjeçar. Rastet e krimeve kanë një grumbullim prej 30 muajsh. Shumica e gjyqtarëve shërbejnë në gjykata komunale, ku ka një sasi të madhe të lëndëve, një jurist mesatar përfundon rreth 280 raste në muaj, diku rreth 14 për ditë pune. <sup>158</sup>

Gjykatat e qarkut kanë më pak presion. Grumbullimi më i madh atje përfshin raste të krimeve serioze, të cilat do të merrnin rreth 30 muaj kohë për t'u shqyrtuar, poqëse nuk do të kishte raste tjera; ankesat në pritje do të merrnin rreth 18 muaj për t'u shqyrtuar. Rastet civile dhe ankesat civile do të mund të përfundoheshin brenda një viti. Megjithatë, të gjitha përveç rasteve kriminale, janë ende duke u paluar shumë shpejtë dhe gjykatat nuk kanë kohe për dëgjimin e tyre. <sup>159</sup>

Vonesa në dëgjimin e rasteve nuk është i vetmi problem. Më shumë se cereku i rasteve civile janë përcjellur nga ankesat përkatëse, duke rezultuar shpesh me anulimin e vendimit origjinal dhe me dhënien e lëndës të njejtës gjykatë dhe të njejtit gjykatës për një vendim të ri. Kjo mund të ndodhë vazhdimisht, duke bërë kështu që rastet të shetiten nga gjykata në gjykatë, ndonjëherë edhe me vite të tëra. <sup>160</sup> Gjyqtari kryesor I gjykatës së qarkut në Prishtinë

<sup>152</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Halit Muharremi, drejtor, sekretariati i këshillit gjyqësor, Prishtinë, 19 janar, 2010.

<sup>153</sup> Projektligji për Gjykatat; komunikim me postë elektronike nga zyra e kryeministrit, 20 prill, 2010.

<sup>154</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i departamentit ligjor të KGJK-së, Prishtinë, 29 mars, 2010.

<sup>155</sup> "Raporti për 2009: Statistikat për Gjykatat e Rregullta", KGJK, fq. 2 për numrin më të vogël; dhe intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i departamentit të statistikave të KGJK-së, Prishtinë, 29 mars, 2010 për numrin më të madh.

<sup>156</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i USAID-it, Prishtinë, 17 mars, 2010.

<sup>157</sup> "Raporti për 2009", KGJK, op. cit., fq. 17. Kanë qenë 95,306 raste të ekzekutimeve dhe 53,739 raste të pazgjidhura civile të datës 31 dhjetor, 2009. Gjatë atij viti, qytetarët raportuan 31,673 kërkesa të reja, prej të cilave gjykatat i kanë dëgjuar 11,467; ata i raportuan 12,162 raste tjera civile, prej të cilave dëgjuan 10,426. Rastet kriminale të pazgjidhura janë 31,434; në vitin 2009, 13,583 raste të reja janë raportuar dhe 12,723 jane dëgjuar.

<sup>158</sup> "Raporti për 2009", KGJK, op. cit., fq. 2.

<sup>159</sup> Ibid, fq. 6. Ishin gjithsej 2,686 raste të shkallës së parë dhe 1,571 raste me të drejtë ankese në fund të vitit 2009; gjykatat komunale regjistroi 1,425 raste të shkallës së parë dhe zgjodhi 1,582 raste, duke regjistruar 1,231 raste të apelit të reja prej të cilave 1,078 u zgjidhën. Poashtu ishin 1,037 raste të shkallës së parë dhe 2,228 raste apeluase civile, me 2,589 raste të reja civile dhe 2,523 të zgjidhura, dhe 2,973 ankesa të regjistruara dhe 2,629 të zgjidhura.

<sup>160</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, gjyqtar i Gjykatës Supreme të EULEX-it, Prishtinë, 29 janar, 2010. Një studim i EULEX-it gjeti se "43.6% e të gjitha rasteve të përfunduara civile kanë qenë raste në të cilat vendimi i shkallës së parë është revokuar dhe janë rikthyer në shkallën e parë"; statistikat sipas të gjitha gjasave i referohen përqindjes së të gjitha rasteve, për të cilat ka pasur ankesa. Raporti i Programeve të EULEX-it, fq. 86.

përkrah këtë rrjedhë të punës, duke thënë se gjykatat e larta nuk kanë kapacitet për ridëgjimin e vetë rasteve, kurse gjyqtarët komunal mësojnë kur u tregohet se ku kanë gabuar.<sup>161</sup> Zyra për Këshillim Disciplinor, e cila është e ngarkuar me hulumtimin e akuzave për moskryerje të detyrës gjyqësore beson se megjithatë shumica e rasteve përfshijnë gjykime jo të drejta të qëllimshme. Për t'i bërë një favor një të akuzuari me rast jo shumë të fortë, gjyqtari thjesht mund të lëshojë një vendim joefektiv, duke ditur se rezultati praktik do të jetë vite të tëra vonese gjatë të cilave pala e dëmtuar do të mbetet e privuar nga të drejtat. Duke bërë këtë, në fakt gjyqtarët "impnojnë vendimet e tyre në një rast të caktuar" pa marrë parasysh ligjin.<sup>162</sup>

Forma tjera të sjelljes së palejueshme po ashtu kontribuojnë në dëmtimin e besimit në gjykata. Shumica e gjyqtarëve i kryejnë dëgjimet në zyrat e tyre, në vend se këtë ta bëjnë në gjykatë. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të mungesës së hapësirës nëpër gjykata, por në anën tjetër krijon përshtypjen se ndonjë marrëveshje sekrete është duke ndodhur prapa dyerve të mbyllura. Gati asnjë nga gjykatat e Kosovës nuk bën incizimin 'audio' të gjykimeve, përkundër faktit se kjo kërkohet me ligj; ekzistojnë mjetet por ato nuk shfrytëzohen. Një sistem i kompjuterizuar i menaxhimit të rasteve, i financuar nga donatorët evropianë, mbetet i pashfrytëzuar sepse gjyqtarët nuk duan të punojnë me te.<sup>163</sup>

Gjykatësit dhe të tjerët në gjykatë shpesh bëjnë thirrje dhe pranojnë thirrje telefonike me celular, gjatë gjykimeve, një veprim ilegal me potencial të madh për keqpërdorim.<sup>164</sup>

Gjykatësit Ekzistojnë shumë raste të cuditshme: për shembull, një gjykatës komunal ishte akuzuar nga një qytetar i cili kërkonte të kthente një copë të tokës të cilën, sic thotë ai, ia kishte dhënë ryshfet gjykatësit, si duket pasi që gjykatësi kishte pranuar ryshfetin por nuk kishte vendosur në favor të qytetarit.<sup>165</sup>

Një i dëmtuar i cili ia arrin ta dërgojë rastin para një gjykatësi të paanshëm dhe të fitojë; mënjanon apo fiton në një apo më shumë ankesa; dhe merr urdhërin e gjykatës për zekëtimin e vendimit, përsëri mund të humbas për shkak të vrimave në ligj. Për shembull, një korporatë e cila humb rastin dhe ka borgj para, mundet thjesht të

shpërbëhet dhe të formohet përsëri, pa bartur kurrfarë përgjegjësie.<sup>166</sup>

Përpjekjet ndërkombëtare për regullimin e sistemit koncentrohen në dy fronte: në reduktimin e numrit të lëndëve duke marrë obligime të panevojshme jashtë gjykatave; dhe në forcimin e kapacitetit gjyqësor duke shtuar gjykatës dhe duke përmirësuar trajnimin e tyre.<sup>167</sup> Qeveria ka marrë pjesë në këtë përpjekje por do të duhej të bënte shumë më shumë.

Më shumë se 80 për qind e kohës së gjykatësve komunalë shpenzohet në akte jogjyqësore sikurse që janë verifikimi I nënshkrimeve, regjistrimi I kontratave dhe gjëra të tilla.<sup>168</sup> Këshilli i Evropës rekomandon që obligime të tilla t'i caktohen zyrtarëve tjerë.<sup>169</sup> Mirëpo, në tërë gjykatat e Kosovës janë vetëm 29 oficerë ligjor, së bashku me 1,263 staf joligjor (asistente, vozitës etj.)<sup>170</sup> Në gjykatës komunale të Prishtinës, më e madhja në vend, me 24 gjykatës dhe me një numër të madh të rasteve, ka vetëm katër oficerë ligjor.<sup>171</sup> Gjykata e qarkut e Prishtinës, me 12 gjyqtarë, po ashtu ka vetëm 4 oficerë ligjor; gjykatësi kryesor i konsideron ata mjaft të vyeshëm dhe do të preferonte ta ketë nga një oficer për cdo gjykatës.<sup>172</sup> Kjo i lë gjykatat pa një resurs që shumë shpejtë dhe në mënyrë domethënëse do të mund të rriste efikasitetin e tyre, kurse në anën tjetër i deprivon avokatët e rinj nga përvoja e cmueshme që fitohet duke punuar përkrah gjykatësve me përvojë. Marrja e një oficeri ligjor për cdo dy gjykatës, me një rrogë përgjysëm më të vogël se ajo e gjykatësit, do t'i kushtonte Kosovës më pak se 600,000 euro. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme, pasi që vonesat në procesin e evaluimit kanë lënë pjesë të sistemit pa gjyqtarët e rregullt.

Një propozim është duke u përgatitur për të vendosur një sistem 'bailif' për të marrë përsipër ekzekutimin e gjykimeve civile, bazuar në modelin holandez, i cili i jep kreditorëve mundësinë e transferimit të çështjes së tyre tek një 'bailif', person privat (i licencuar), i cili do të përfitonte

<sup>161</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Anton Nokaj, president i gjykatës së qarkut, Prishtinë, 8 prill, 2010.

<sup>162</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, zyra e këshilltarit disiplinor, KGJK, Prishtinë, 19 janar, 2010.

<sup>163</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Anton Nokaj, president, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Prishtinë, 8 prill, 2010.

<sup>164</sup> Raportit i Programeve i EULEX-it, fq. 90; "Monitorimi i Gjykatave", BIRN, maj 2009, fq. 25-26, 28.

<sup>165</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Pejë, mars, 2008.

<sup>166</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i USAID-it, Prishtinë, 17 mars, 2010.

<sup>167</sup> Ibid.

<sup>168</sup> "Raporti për 2009", KGJK, op. cit., fq. 17.

<sup>169</sup> "Rekomandimet numër R (86) 12 i komitetit të ministrave në shtetet anëtare për masat për parandalimin dhe reduktimin e lëndëve nëpër gjykata", Këshilli i Evropës, 13 shtator, 1986. Raporti i Programeve i EULEX-it i referohet këtij rekomandimi vetëm kalimthi (fq. 90) por në kontekstin e gjykatave të qarkut, të cilat nuk janë të bllokuara me detyra të vështira.

<sup>170</sup> Raporti i Programeve i EULEX-it, fq. 89.

<sup>171</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Nuhi Uka, president, gjykata komunale e Prishtinës, 27 janar, 2010.

<sup>172</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Anton Nokaj, president, gjykata komunale e Prishtinës, Prishtinë, 8 prill, 2010.

financiarisht nga kjo.<sup>173</sup> USAID-i është duke zhvilluar programe mbi zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve, të cilat do t'i ofronin palëve mundësitë e ndërmjetësimit dhe vendimit obligues sa i përket mosmarrëveshjeve.<sup>174</sup>

40 gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it kërkojnë të forcojnë sistemin e drejtësisë, duke shërbyer nëpër gjithë Kosovën me gjykatës lokal, shpeshherë duke dëgjuar rastet si pjesë e paneleve.<sup>175</sup> Ata më lehtë merren me raste më të vështira, sikurse ato që janë të motivuara politikisht apo etkinisht. Përkthimi i ngadalëson gati sa 'faktori i treve'<sup>176</sup>, kështu që ata merren me relativisht më pak raste. Gjykatësit e EULEX-it ngrisin kualitetin dhe integritetin e gjyqësisë. Ata rrespektohen gjërësisht nga kolegët lokal me të cilët bashkëpunojnë ngushtë.<sup>177</sup> Në të njëjtën mënyrë, ata janë ata të cilët mund të mbikqyrin gjeneratën e ardhshme të juristëve të Kosovës.

Por EULEX-i gjithashtu ka mungesë të gjyqtarëve, dhe ka qenë 40 përqind më poshtë se kuota e tij në prill, 2010, sepse ka pasur një humër shumë të ulët të aplikantëve.<sup>178</sup> Arsyja më e mundshme për këtë është vendimi për të kërkuar së paku tri vite përvojë pune si gjyqtar, duke e zvogeluar kështu numrin e aplikantëve kryesisht në gjykatës në prizon, grup ky i cili si duket nuk është i gatshëm të zhvendoset dhe të fillojë jetën në Kosovë; dhe vendimi për të kërkuar nënshtetësinë e njërit nga shtetet e BE-së apo njërin nga një grup tjetër i shteteve.<sup>179</sup> Tri vite punë si gjykatës është një kërkesë e arsyshme. BE-ja do të duhej të bënte krejt cka mundet të rrisë numin e aplikantëve të kualifikuar dhe t'i inkurajojë shtetet të dërgojnë juristë. Shtetet anëtare do të duhej të krijonin struktura nacionale për lehtësimin e marrjes së personelit në misione sikurse EULEX-i dhe të pajtoheshin për krijimin

e një departamenti të BE-së me gjykatës dhe prokuror të gatshëm dhe në dispozicion.

## B. KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është organ i pavarur me kompetenca të gjera mbikqyrëse. Ky këshill emëron, ndërmerr masa disiplinore dhe pushon nga puna gjyqtarët, shyrton dhe gjykon ankesat dhe shpall standardet dhe praktikën e punës. Pra, kompetencat e tij janë aq të gjera sa që as ministria e drejtësisë dhe as ndonjë organ tjetër qeveritar nuk ka rol udhëheqës ose administrativ ndaj gjyqtarëve, madje edhe kërkesat e pagave anashkallojë ministrinë e drejtësisë dhe shkojnë, nëpërmjet ministrisë së financave, drejtpërdrejt në Kuvend.

Ky aranzhim, pjesë e një lëvizje që ka pasur për qëllim izolimin e gjyqtarëve nga politika dhe ekzekutivi, filloi së aplikuari në vitin 1994 kur Këshilli i Evropës ka rekomanduar që "autoriteti që merr vendime për përzgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve duhet të jetë i pavarur nga qeveria dhe administrata".<sup>180</sup> Si rezultat i kësaj, shumë shtete evropiane kanë ngritur këshille përmes të cilëve gjyqësori vetadministrohet, edhe pse kompetencat ndryshojnë nga një shtet në tjetrin.<sup>181</sup> Verzioni i Kosovës është i trashëguar nga UNMIK-u, dhe në të njëjtën kohë adapton një "qasje amerikane" të pavarësisë absolute gjyqësore, që është në shpërputhje me traditat Evropiane, sipas të cilave ministrisë së drejtësisë i takojnë disa kompetenca të caktuara. Ky mund të ketë qenë një gabim. Sipas këtij modeli, gjyqësori vetadministrohet dhe në këtë mënyrë qeveria nuk do të ishte përgjegjëse edhe në rast të dështimit të tij. Si rezultat, do të pamundësoheshin favorizimet gjyqësore dhe nepotizmi, si dhe qasja favorizuese dhe moskalimi nëpër linja të qarta gjyqësore për raste të caktuara të korrupsionit. As gjyqësori në anën tjetër nuk do të kishte zë dhe nuk do të kishte mundësi të avokojë në

<sup>173</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i USAID-it, Prishtinë, 17 mars, 2010; konsulent ndërkombëtar, KGJK, Prishtinë, 4 shkurt, 2010.

<sup>174</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i USAID-it, 17 mars, 2010.

<sup>175</sup> "Mbi juridiksionin, zgjedhjen dhe alokimin e rasteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it", ligji numër 03/L-053.

<sup>176</sup> Ushtruesi i detyrës i kryeprokurorit të EULEX-it kishte vlerësuar se stafi i tij ndërkombëtar do të mund të kryente një të tretën e lëndëve që i kanë kryer në vendet prej nga vijnë për shkak të kërkesave reth përkthimit; e njëjta vlen edhe për gjyqtarët; Intervistë e Grupit të Krizave, Johannes Pieter Van Vressëijk, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>177</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i USAID-it, Prishtinë, 17 mars, 2010; gjyqtarë dhe prokurorë lokal, Prishtina, janar-prill, 2010.

<sup>178</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i EULEX-it, Prishtinë, 30 mars, 2010.

<sup>179</sup> Qytetarët e Kanadasë, Kroacisë, Norvegjisë, Zvicrrës, Turqisë dhe SHBA-së mund të aplikojnë për pozita ndërkombëtare në EULEX.

<sup>180</sup> Raporti i Programeve të EULEX-it, fq. 87; citat i rregullit I (2) (c) [e dhënë gabimisht si 1 (c)], Këshilli i Evropës, "Rekomandimi numër R (94) 12 e komitetit të ministrave të shteteve anëtare mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve."

<sup>181</sup> EULEX-i kritikon ligjin e Kosovës mbi Këshillin Gjyqësor sepse katër nga nëntë gjyqtarët në të caktohen nga parlamenti; Raporti i Programeve të EULEX-it, fq. 88. Kjo si duket keqinterpreton rekomandimin e Këshillit të Evropës, i cili lejon që disa "tradita lejojnë caktimin e gjyqtarëve nga parlamenti" dhe sygjeron që në ato sisteme, "procedurat për caktimin e gjyqtarëve janë transparente dhe të pavarura në praktikë". Nëse gjyqtarët mund të caktohen nga qeveria, sipas kësaj, caktimi nga një këshill i pavarur, i cili vetë është pjesërisht i caktuar nga qeveria është poashtu i pranueshëm, si pjesë e kushteve të njëjta të transparencës dhe pavarësisë.



qeveri dhe as të ndikojë në politikë përmes asnjë rruge institucionale.<sup>182</sup>

Duke pasur parasysh rolin e saj qendror në drejtimin e sistemit gjyqësor, është me rëndësi që KGJK-së të plotësohet me personel dhe të jet funksional, por momentalisht ai është lidhur në një rreth vicioz: shumica e pozitave janë të rezervuara për gjyqtarë dhe nuk mund të plotësohen deri pas përfundimit të procesit të verifikimit në të cilin process KGJK-ja luan rol shumë të rëndësishëm. Deri në mars të vitit 2010, ky këshill përbëhej nga tre anëtarë të cilët nuk ishin gjyqtarë dhe dy zyrtarë të EULEX-it. Tre gjyqtarë të zgjedhur në mars, pas raundit të parë të verifikimit të KPGJP-së, janë emëruara menjëherë si staf me orar të plotë të KPGJP-së dhe nuk do të jetë aktiv në KGJK deri sa të përfundojë procesi i verifikimit, në fund të vitit 2010.<sup>183</sup>

Në ndërkohë, Kosovës i mungon menaxhimi efektiv gjyqësor. Gjyqtarë të korruptuar mbeten në pozitë: ankesat në adresë të ZKD-së janë rritur, nga 73 sosh në vitin 2001 në 400 në vitin 2008 dhe 293 sosh në vitin 2009.<sup>184</sup> Që nga viti 2001 ZKD ka shqyrtuar 120 nga këto dhe i ka dërguar te ZKD-ja për vendim, 76 prej tyre janë kundër gjyqtarëve, ndërsa 118 raste të tjera mbesin nën hetime. Para pavarësisë KGJK-ja ka shqyrtuar këto raste me një ritëm shumë të ngadalësuar, por procesi është shpejtuar që nga pavarësia.<sup>185</sup> Megjithatë, KGJK-së, me përbërjen e tij jo të plotë, ka ngurruar të nxjerrë vendime përfundimtare dhe të detyrueshme, duke e bërë kështu procesin joefektiv.<sup>186</sup> Në të vërtetë nga qindra e ankesa dhe raste janë pezulluar vetëm dhjetë gjyqtarë - tre prej të cilëve pas pavarësisë.<sup>187</sup>

Kontrolli Gjyqësor është bllokuar nga paraliza e KGJK-së. Ai është i ngarkuar me hetimin e punës së gjyqësorit dhe të prokurorisë, duke identifikuar të metat si locale ashtu edhe ato sistemike si dhe duke rekomanduar zgjidhje për punën e KGJK-së. Për shembull në vitin 2007, ka rekomanduar që “KGJK-ja dhe [ministra e drejtësisë]

të vendosin mekanizmat e bashkëpunimit për të marrë vendime për paraburgimin [heqjen] e të paraburgosurve”.<sup>188</sup> Auditorët kanë bërë 232 rekomandime midis viteve 2006 dhe 2008, disa jokontraverzal, por asnjë prej këtyre rekomandimeve nuk është implementuar, pasi që KGJK-ja nuk i ka marrë ato paraqyshë. Tani ajo ka pezulluar punën me rastet e reja dhe është fokusuar në implementimin e rekomandimeve të mëparshme.<sup>189</sup>

## C. PROKURORIA

Shumica e problemeve që afektojnë gjykatat vërehen edhe prokurorët publikë. Vetëm një prokuror është nën moshën 40 vjeçare. Numri i tyre është shumë më i vogël në krahasim me vendet e tjera ish-jugosllave që vijnë nga një trashëgimi e përbashkët ligjore: me katër deri në pesë prokurorë në 100,000 banorë, në krahasim me 7,3 në Bosnje-Hercegovinë, nëntë në Slloveni, trembëdhjetë në Kroaci dhe 13,4 në Mal të Zi.<sup>190</sup> Zbatohet e njëjta procedurë e KPGJP-së për verifikim, me pasoja të njëjta: prokurorët, të cilët kanë dështuar në pikëpamje etike mbeten përkohësisht në punë, dhe më të mirët në nivelet komunale dhe ato të qarkut janë angazhuar për punë shtetërore dhe zyre të vecanta të prokurorisë (të krimit të organizuar dhe korrupsionit), duke krijuar zbrazëti të mëdha.<sup>191</sup> Sipas një studimi lokal prokurorët janë të mbingarkuar, vrapojnë nga njëra sallë e gjyqit në tjetrën, duke u përpjekur të trajtojnë dy raste që dëgjohen në të njëjtën kohë.<sup>192</sup> Rrogat janë të ulëta.

Prokurorët knaë gjithashtu detyrat që jashtë sallës së gjyqit që marrin kohë, të cilat ata nuk janë në gjendje për t'i përbushur.<sup>193</sup> Ata mbikqyrin për policinë – në teori, secili rast hetimor i bërë nga policia duhet të drejtohet nga një prokuror, i cili duhet të marrin pjesë në vendin e krimit, të nxjerrë urdhëra dhe të ndër marrë detyra të tjera.<sup>194</sup> Zyra e prokurorit të Qarkut të Prishtinës, e cila mbulon një zonë të madhe me përafërsisht një milion banorë, deri kohët e fundit ka pasur vetëm tre prokurorë

<sup>182</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i sundimit të ligjit të UNMIK-ut, 12 janar, 2010.

<sup>183</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i USAID-it, Prishtinë, Prishtinë, 17 mars, 2010.

<sup>184</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Kadri Begolli, drejtor, zyra e këshilltarit disiplinor, Prishtinë, 19 janar, 2010. Begolli beson se rënia e numrit të ankesave qysh nga viti 2008 reflekton më shumë humbjën publike të besimit në sistem sesa rënien e nivelit të korrupsionit.

<sup>185</sup> KGJK-ja ka ndarë drejtësinë në vetëm 50 ankesa, mes viteve 2001 e 2008; KGJK-ja e re, pas pavarësisë ka përfunduar 50 rastet në vitin 2009, me 20 raste tjera në proces; ibid.

<sup>186</sup> <sup>155</sup> Intervista të Grupit të Krizave, anëtar i KGJK-së, Prishtinë, 25 janar, 2010.

<sup>187</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i departamentit ligjor të KGJK-së, Prishtinë, 29 mars, 2010

<sup>188</sup> “Rekomandimet e auditorëve gjyqësor”, njësia auditore gjyqësore e KGJK-së, NJAGJ/09/hh/023, 19 korrik, 2009.

<sup>189</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Hydajet Hyseni, koordinator, auditor i gjyqësorit, Prishtinë, 25 janar, 2010.

<sup>190</sup> Reporti i programeve të EULEX-it, fq. 85, 89.

<sup>191</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Hilmi Zhitija, ish-kryeprokuror i Kosovës, Prishtinë, 7 dhjetor, 2009.

<sup>192</sup> “Monitorimi i gjykatave”, op. cit., fq. 25.

<sup>193</sup> Shërbimi i prokurorisë poashtu nuk i është përshtatur tërësisht rolit të ri që nga viti 2004, kur posti i gjyqtarit hulumtues është hequr dhe shumica e detyrave të tij i janë transferuar prokurorëve. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i shtyllës së krimit në polici, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>194</sup> Procedura kriminale e përkohshme e Kosovës, artikujt 221, 229 ff

për një grup rastesh që mund të zënë me punë njëzet apo më shumë prokurorë.<sup>195</sup>

Zyrtarët kanë një reputacion për ndershmëri, me vetëm trembëdhjetë ankesa për korrupsion të lëshuar nga ZKD-ja që nga viti 2001, tri prej të cilave rezultuan me pezullim nga puna.<sup>196</sup> Por produktiviteti i tyre është jashtëzakonisht i ndryshueshëm: prokurorët komunal parashihet të shqyrtojnë 60 raste në muaj, ndërsa prokurorët e qarkut 25. Shumica përbushin apo edhe tejkalojnë këto pritje, por disa shqyrtojnë 40 raste në javë, ndërsa të tjerë bëjnë vetëm dy ose tre.<sup>197</sup> Prokurorët shpesh paraqiten në gjykatë të papërgatitur dhe i adresohen gjykatës përmendësh duke kërkuar dënimin maksimal pa ndërlidhje (ose ndonjëherë duke mos ditur) faktet reale të rastit.<sup>198</sup> EULEX-i ka vërejtur se prokurorët ftojnë të afërmit e viktimave “për të dalë para gjykatave përkundër faktit se ishte e qartë se dëshmitë e tyre nuk janë relevante ... [dhe] edhe pse përfaqësuesi i familjes nuk ka dëshmuar krimin e dyshuar dhe dëshminë e tyre mund të jenë vetëm thashetheme”, për shkak të “obligimit kulturore ndaj familjeve të palëve të dëmtuara”.<sup>199</sup>

Nuk ka menaxhim efektiv të prokurorëve. Kryeprokurori shtetëror ka autoritet të kufizuar dhe deri kohët e fundit ka udhëhequr pak ose aspak, përveç udhëzimeve të “ndjekin ligjin”.<sup>200</sup> Zyra e tij është në të vërtetë një shërbim i apelit gjyqësor me një staf të vogël dhe nuk ka kontakte reale me kolegët në teren. Nuk ka strategji të dukshme për priorizimin e hetimeve dhe rasteve dhe për targetimin e formave më të dëmshme të krimit dhe të kriminelëve më të rrezikshëm. Në vend të kësaj, këto vendime shpesh i lihen policisë. Çdo zyrë e prokurorisë është lënë të punojë në vete, pa pasur ku të drejtohet për udhëzime, dhe zgjedhja dhe menaxhimi i rasteve shpesh duken si një “mish-mash”.<sup>201</sup>

Kosova kohëve të fundit ka krijuar një departament të posaçëm kombëtar për krimin e organizuar, krimet e luftës dhe korrupsionin, së bashku me EULEX-in ku në

përbrëje hyjnë dhjetë kosovarë dhe gjashtë (për tu bërë njëmbëdhjetë në maj) prokurorë ndërkombëtarë.<sup>202</sup> Rekrutimi ka qenë i vështirë, pavarësisht nga një pagë bonus e konsiderueshme. Edhe në këtë zyrë, disa besojnë se ka raste, veçanërisht që ndërlidhen me korrupsionin e nivelit të lartë të qeverisë, të cilat janë politikisht shumë të ndjeshme për t'u trajtuar. Megjithatë, prokurorët vendorë kanë marrë për shqyrtim raste jashtëzakonisht sfiduese, duke përfshirë një vrasje të shumfishtë në Prishtinë, ku të dyshuarit janë policë, të cilët besohet të ketë qenë duke punuar me disa persona të tjerë të paidentifikuar asnjëherë të cilët mund të jenë ende oficerë në detyrë.<sup>203</sup> Barra e hetimeve të korrupsionit të nivelit të lartë nisur nga EULEX-i në prill 2010 do të ngarkojë këtë departament, i cili do të ketë nevojë për përkrahje të fuqishme ndërkombëtare.

Kontributi i përgjithshëm i EULEX-it ofrohet nga ana e tetëmbëdhjetë prokurorëve ndërkombëtarë, nga një 25 të planifikuar.<sup>204</sup> Prokurorët të Kosovës të intervistuar nga Grupi i Krizave shprehin respektin dhe vlerësimin për kolegët e tyre ndërkombëtar, të cilët i favorizojnë pakrahasueshëm në krahasim me prokurorët e UNMIK-ut.

#### D. MARDHËNIET PROKURORI-POLICI

Pothuajse të gjithë të intervistuarit nga Grupi i Krizave janë pajtuar se marrëdhëniet midis policisë dhe prokurorëve janë të varfëra. Prokurorët janë ankuar se policia mbanë informacione prej tyre, nuk pranojnë të ndjekin urdhrat, bëjnë hetime sekrete e të motivuara politikisht, dhe i ngarkojnë ata me punë të panevojshme. Policia akuzon se “80 përqind të kohës”, prokurorët nuk paraqiten në vendin e krimit, neglizhimjnë studimin e dosjes së rastit para gjyqit, të përpiqet të zhvendosë sa më shumë punë që të jetë e mundur te policia; dhe nuk i mbajnë të informuar në lidhje me ecurinë e rasteve.<sup>205</sup> EULEX-i i ka përshkruar si “dy subjektet që veprojnë në orbita të veçanta: kontakti në mes të Prokurorëve Publik dhe hetuesve të SHPK-së është minimal”.<sup>206</sup>

Në teori, prokurorët mund të lëshojnë urdhër për të tërë PK-në, por në praktikë ata e kanë parasyshë se policët gjithmonë do të jenë besnikë fillimisht ndaj eprorëve të tyre të policisë, të cilët bëjnë emërimin dhe promovimin e tyre. Prokurorët besojnë se Kosova ka nevojë për një

<sup>195</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Ismet Kabashi, kryeprokuror, Prishtinë, 31 mars, 2010; Osman Kryeziu, kryeprokuror, qarku i Prishtinës, Prishtinë, 8 prill, 2010.

<sup>196</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Kadri Begolli, drejtor, zyra e këshilltarit disiplinor, Prishtinë, 19 janar, 2010; Hasime Osmani, departamenti ligjor i KGJK-së, Prishtinë, 29 mars, 2010

<sup>197</sup> Intervista të Grupit të Krizave, këshilltar i lartë i policisë së EULEX-it, Prishtinë, 30 mars; Ismet Kabashi, kryeprokuror, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>198</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, prokuror i EULEX-it, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>199</sup> Raporti i Progameve i EULEX-it, fq. 96.

<sup>200</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Hilmi Zhitija, ish-kryeprokuror i Kosovës, Prishtinë, 7 dhjetor, 2009.

<sup>201</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Aleksandër Lumezi, kryeprokuror, komuna e Prishtinës, Prishtinë, 13 janar, 2010.

<sup>202</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, zyra e prokurorit special, Prishtinë, 9 prill, 2010.

<sup>203</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, prokuror, zyra speciale e prokurorit, Prishtinë, 4 shkurt, 2010

<sup>204</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Johannes Pieter Van Vresëijk, kryeprokuror i EULEX-it, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>205</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë policorë dhe prokurorë shtetëror të Kosovës, Prishtinë, mars, 2010.

<sup>206</sup> Raporti i Progameve i EULEX-it, fq. 29

polici të veçantë gjyqësore, nën kontrollin e tyre të drejt-përdrejtë.<sup>207</sup> Policia ven në pah se nuk ka nevojë ligjore për një organizatë të veçantë dhe se tashmë prokurorët kanë të gjithë autoritetin e nevojshëm ligjor.<sup>208</sup> Një polici gjyqësore e veçantë do të shkaktonte probleme delikate juridike. Kërkesa është më shumë një reflektim i frustrimit të thellë dhe mosbesimit të prokurorëve sesa një propozim serioz.

Një pjesë e këtij tensioni do të vazhdojnë derisa shërbimi prokurorial të jet kompletuar me staf të trajnuar në mënyrë adekuate, por disa hapa mund të përmirësojnë disa çështje më shpejt. Policia duhet besuar për të hetuar rastet e thjeshta vet, dhe pastaj të shkojë në prokurori me një dokumentacion më shumë ose më pak të plotë. Policia veç e bën këtë tashmë, por praktika duhet të institucionalizohet, me pak mbikëqyrje, e cila aktualisht mungon. Në të vërtetë, sistemi ofron kontroll të dobët për të parandaluar shpërdorimin autoritetit të policisë dhe për ta ndëshkuar atë. Hetimet e tyre, duke përfshirë marrjen në pyetje, duhet të video-dhe audio-regjistrohen.

Rastet serioze kanë nevojë për punë të përbashkët ndërmjet prokurorëve dhe hetuesve të policisë, dhe kjo duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ekipet duhet të specializohen në lloje të veçanta të rasteve, të tilla si krimi financiar dhe ekonomik, shkelja e të drejtave të njeriut dhe kategoritë e tjera që kanë nevojë për ekspertizë të veçantë.<sup>209</sup> Sa më shumë të jetë e mundur, prokurorët e njëjtë duhet të punojnë me policët e njetë, në mënyrë që të ndërtojnë marrëdhënie të besueshme të cilat aktualisht mungojnë. Departamenti i posaçëm i hetimeve do të bashkohet me 30 hetuesit e zgjedhur të policisë në një forcë vepruese mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar, një model që duhet të zbatohet, formalisht ose joformalisht, në fusha të tjera.<sup>210</sup>

## IV. VERIU I KOSOVËS

Sistemi juridik në Kosovë në veri të lumit Ibër vepron sipas rregullave të tjera dhe në shumë aspekte pothuajse nuk funksionon fare.<sup>211</sup> Kalimi i lumit të bën të ndihesh sit ë kalosh një vijë kufitare brenda zonës Shengen të BE-së: nuk ka shenja apo formalitete, por befaz gjithçka është ndryshe: targat, shenjat e rrugëve dhe dyqaneve, monedha dhe gjuha që dëgjohe në rrugë. Veriu është pjesë e Kosovës, por për banorët e saj (kryesisht serbë) dhe pothuajse edhe për vizitorët ndihet si pjesë e Serbisë. Autoriteti i Prishtinës pothuajse nuk është fare i pranishëm, dhe administrata civile nivel lokal drejtohet sipas në ligjit serb, duke u përgjigjur në Beograd, edhepse Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999) përjashtoi policinë serbe dhe personelin e sigurisë.<sup>212</sup> As zyrtarët komunal dhe as gjykatat e Serbisë në Veri nuk e përdorin PK-në; atonë vend të saj, mbështeten në vullnetin e mirë të popullatës, dhe asgjë nuk mund të zbatohet, sepse, si institucione të Republikës së Serbisë, ato nuk mund të ndërlidhet me një organ të Republikës së Kosovës.<sup>213</sup> Kjo mungesë e policisë e bën sistemin paralel me pak efikas, pavarësisht nga paratë e Beogradit, dhe ndihmon në ruajtjen e imazhit të Veriut si të paligjshëm.

Pjesën veriore e Mitrovicës është e qytetëruar dhe plot jetë, dhe madje edhe qytetet më të vogla dhe fshatra bëjnë jetë mesatare në krahasim me pjesën tjetër të Kosovës. Kjo është për shkak se shumica e financimit të Beogradit për serbët e Kosovës shkon në veri.<sup>214</sup> Investimet janë shumë të dukshme – zona relativisht e vogël dhe rurale është e ndërtuar me ndërtesa të reja, salla sportive, banesa dhe një kampus universitar në të njëjtin nivel memë të mirin në Beograd. Komunitat punojnë me kapacitet të plotë dhe të mburren me makinat për mbledhjen e mbeturinave

<sup>207</sup> Intervistë e Gupit të Krizave, prokuror, zyra e prokurorit shtetëror, Prishtinë, 5 shkurt, 2010

<sup>208</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë policorë, Prishtinë, mars, 2010.

<sup>209</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i njësive ligjore, Zyra Ndërkombëtare Civile, Prishtinë, 23 mars 2010.

<sup>210</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, zyra e prokurorit special, Prishtinë, 9 prill, 2010. Ekziston një mosmarrëveshje mes prokurorit dhe policisë rreth stafit të task- forcës, ku prokurorët duan që hulumtuesit tu caktohen përgjithmonë atyre kurse policia që preferon të mbajë kontrollin mbi investiguesit duke I angazhuar ata prej rastit në rast.

<sup>211</sup> Veriu i Kosovës përbëhet prej nga komunat e Leposaviçit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, si dhe nga pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës. Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 165, *Duke bashkuar Mitrovicën e ndarë*, 13 shtator, 2005

<sup>212</sup> Për shumë vite, Serbia ka mbajtur oficerët e saj policor në mënyrë të fshehtë në Kosovë; rreth 400 prej tyre janë ende atje, kryesisht në Veri, të cilët tani operojnë më shumë si operativë të inteligjencës se sa si policë. Raporti për Evropë i Grupit të Krizave, numër 200, *Integrimi serb në Kosovë; Duke marrë hovin*, 12 maj, 2009.

<sup>213</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i serbëve të Kosovës, Mitrovica Veriore, 20 janar, 2010.

<sup>214</sup> Në kulmin e saj, në vitet 2006-2007, ndihma serbe dhënë Kosovës kishte arritur rreth €500 milion në vit, pjesa më e madhe e të cilave shkoi në paga, pensione dhe skema sociale, së bashku me shpenzimet kapitale. Qysh prej asaj kohe, kjo shumë është zvogëluar; Grupi i Krizave vlerëson se Serbia tani dërgon mes €200 dhe €230 milion në vit, dhe se €110-€130 milion shkojnë për Veriun, që merr pjesën më të madhe të investimeve kapitale. Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave, *Integrimi serb në Kosovë; Duke marrë hovin*, 12 Maj 2009.

dhe makinat për lirim të rugëve nga bora ndër më modernet në Kosovë. Spitali është i madh, me personel të mjaftueshëm dhe i pajisur me mjete dhe tërheq pacientë nga e gjithë Kosova.

## A. KRIMI

Reputacioni për mungesë të ligjit është vetëm pjesërisht i merituar. Veriun i mbajtur nga serbët është rreth gjysma e territorit të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë, por përben vetëm rreth një të pestën e popullsisë së saj.<sup>215</sup> Ajo është përgjegjëse për më shumë se një të katërtën e arrestimeve për vjedhje dhe për më shumë se një të tretën e arrestimeve për sulme,<sup>216</sup> pothuajse të gjitha për shkak të Veriut të Mitrovicës, ku 22.000 banorët që jetojnë në këtë pjesë përbëjnë më pak se 6 për qind të popullsisë, por janë përgjegjës për 18 për qind të rasteve të krimit dhe 25 për qind të rasteve të krimeve të dhunshme.<sup>217</sup> Me një minoritet të konsiderueshëm shqiptar dhe boshnjak, shënohen edhe krime sporadike ndëretnike.<sup>218</sup> Por edhe pjesa veriore e Mitrovicës është mjaft e sigurt krahasuar me shumë zona urbane në botën e zhvilluar: nëntë arrestimet e bëra për dëmtim serioz trupor në vitin 2009, për shembull, janë shumë vetëm në krahasim me nivelin e përgjithshëm të ulët të krimit në Kosovë. Të tri komunat e tjera veriore janë kryesisht në ose nën mesataren rajonale

Një burim kryesor i krimit dhe pasigurisë është vija kufitare midis Serbisë dhe Kosovës, veçanërisht në Portat 1 dhe 31. Serbia ka filluar fushatën kundër kontrabandës që nga maji i vitit 2008, duke caktuar në anën e saj të portave 1 dhe 31 limitin e shumave për kalim kufitar, me prani të mëdha të policisë të mbështetur nga zyrtarë të doganave të cilët kryejnë kontrole të rregullta. Kjo ka zvogëluar dukshëm kontrabandën e karburanteve dhe

mallrave të tjera, të cilat më parë i kushtonin shtrenjtë Serbisë në mbledhjen e të hyrave. Një aksion që goditi mbi 90 persona, duke përfshirë edhe disa oficerë të policisë serbe, të arrestuar që prej fillimit të vitit 2009 në lidhje me kontrabandën me Kosovë, pothuajse i ka dhënë fund kësaj veprimtarie, e cila në të kaluarën ka ndodhur në mes të ditës, dhe ka pasur së paku heshtjen si mbështetje nga ana e figurave politike lokale dhe shtetërore.<sup>219</sup>

Në anën e Kosovës, situata në të dy portat po përmirësohet ngadalë. Objektet e djegura në shkurt të vitit 2008 janë riparuar dhe zëvendësuar. Grupi i Krizave ka vërejtur një prani të dukshme të EULEX-it, ndërsa PK qëndronin brenda zyrave dhe ishin në numër të vogël. Nuk kishte asnjë autoritet doganor përveç anëtarëve të EULEX-it të cilët merrnin informacione në lidhje me automjetet që hynin në Kosovë. Në pamundësi për të bërë shumë vet, menaxhmenti i PK-së ankohet se “EULEX-i duhet shtyrë në çdo gjë para se të veprojnë”. Në shkurt të vitit 2010 EULEX-i filloi kontrollin e dokumenteve të njerëzve që hyjnë në Kosovë nga porta veriore. Grupi i Krizave ka vërejtur se jo të gjitha automjetet kontrollohen, dhe edhe kur ato janë kontrolluar, kontrolli nuk ishte mjaft i plotë. EULEX-i vepron me sistem të dyfishtë, thjesht duke inspektuar dokumentet serbe dhe duke i regjistruar dokumentet e tjera në kompjuter, duke i bërë kështu Portat 1 dhe 31 pika të kontrollit të policisë për serbët dhe kalime kufitare për të gjithë të tjerët.<sup>220</sup> EULEX-i thotë se është i përgatitur për të ushtruar kontrollin e plotë doganor, por nuk mund ta bëjë këtë pa u arritur një marrëveshje plotë politike.<sup>221</sup>

Zyrtarët e BE-së dhe të OKB-së janë dakort se aktivitete të tjera kriminale, veçanërisht trafiku i drogës, vazhdojnë në këtë zonë dhe përbëjnë një problem të rëndësishëm rajonal.<sup>222</sup>

## B. GJYKATAT

Në veri të Kosovës nuk ka gjykata komunale, në vend të kësaj, gjyqtarët serbë të Kosovës dëgjojnë rastet civile ku përfshihen shkurorëzimet, trashëgimitë dhe rate të ngjaj-

<sup>215</sup> Drejtorati rajonal i policisë në Mitrovicë mbulon komunat në veri të Ibrit, si dhe pjesën më të madhe dhe më të populluar të jugut të Mitrovicës dhe komunave të Skenderajit dhe Vushtrisë. Komunat me shumicë serbe zyrtarisht kanë rreth 72,000 banorë, 19 përqind të totalit të rajonit të Mitrovicës.

<sup>216</sup> Drejtorati rajonal i policisë në Mitrovicë, raporti vjetor për 2009, të dhëna Grupit të Krizave; vjedhjet ndahen në vetëm “vjedhje e thjeshtë” dhe “vjedhje e madhe”, sulmi në “shkaktim i lëndimeve të lehta trupore” dhe “shkaktim i lëndimeve të rënda trupore” dhe “dhunë familjare”. Prej tyre vetëm në Veri ndodhën 27 përqind të të parës dhe 34 përqind të të dytës. Në tërë rajonin, në vitin 2009 ndodhën vetëm katër vrasje, dy në Mitrovicën Jugore, dhe nga një në Skenderaj dhe Zubin Potok.

<sup>217</sup> Mitrovica Veriore ka një numër të madh të të rinjve dhe një pjesë të madhe të të shpërngulurve të brendshëm, shumë prej të cilëve jetojnë në kushte të rënda, dhe janë cak i krimeve të vogla ndërsa operojnë me kiosqe dhe dyqane ilegale.

<sup>218</sup> Rreth 2,200 shqiptarë dhe 1,320 boshnjakë jetojnë në Mitrovicën e Veriut, ku të dhënat e policisë tregojnë për 40 incidente të “motivuar etnikisht”, në vitin 2009, numër që mesiguri është një nënvlerësim.

<sup>219</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, mars 26, 2010.

<sup>220</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i shtyllës së policisë kufitare, Prishtinë, 10 shkurt, 2010.

<sup>221</sup> Komunikim me postë elektronike i Grupit të Krizave, Sekretariati i Këshillit të Përgjithshëm të Evropës, maj, 2010.

<sup>222</sup> Intervista të Grupit të Krizave, komandanti i policisë rajonale të UNMIK-ut, Mitrovicë, gusht 2007; officer i inteligjencës së policisë, Mitrovica, shtator, 2007 dhe mars 2008; officer i PK-së, Mitrovicë, gusht, 2008; dhe zyrtarë të BE-së, Bruksel, mars, 2010.

shme, në zyrat apo në apartamentet e tyre.<sup>223</sup> Serbia, në mënyrë shumë publike, riemëron gjyqtarë nën sistemin e vet gjyqësor në Kosovë.<sup>224</sup> Prokurorët në veri janë gjithashtu pjesë e sistemit serb. Por gjykatësit nuk mund të dëgjojnë rastet penale, dhe policia e Kosovës nuk mund të bashkëpunojnë me ta.

Problemi shtrihet përtej zonave të mbajtura nga serbët, në gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, e cila është e vendosur në veriun e mbajtur nga serbët, por që teknikisht mbulon zonat serbe të Kosovës, komunat e Skenderajt dhe Vushtrrisë të populluara kryesisht nga shqiptarë si dhe në gjysmën jugore të Mitrovicës. Ajo ka pushuar së funksionuari pas pavarësisë në shkurt 2008; gjyqtarët e saj shqiptarë janë “në ekzil” në Vushtrrinë e afërt, dhe nuk janë duke dëgjuar raste. Përpjekjet për të riintegruar këtë gjykatë në sistemin e Kosovës mbaruan me dhunën vdekjeprurëse në rrugë, më 17 mars 2008, kur policia e UNMIK-ut sulmuan kompleksin e gjykatës së Mitrovicës në përpjekje për të dilokuar demonstruesit serbë, të cilët nuk pranuan të lirojnë objektin.<sup>225</sup> Që nga prilli i vitit 2009, një panel i vetëm i gjykatës së qarkut i përbërë prej tre gjyqtarëve të EULEX-it ka dëgjuar dymbëdhjetë raste, përndryshe, për më shumë se dy vjet, në të vërtetë nuk ka pasur drejtësi penale në Qarkun e Mitrovicës.<sup>226</sup>

Gjykata e qarkut në Mitrovicë ka më së shumti rate të patrajtuara në Kosovë: rreth 10.000 raste.<sup>227</sup> Edhe në qoftë se shumica e këtyre janë çështjet shumë të thjeshta, trajtimi i tyre kërkon vite të punës.<sup>228</sup> Ratet më të rënda

janë ato penalet ku të dyshuarit gjinden në arrest. Kur arriti EULEX-i kanë qenë rreth 50 raste të tilla, duke përfshirë edhe ratin e një të dyshuari për vrasje i cili kishte kaluar dy vjet në paraburgim dhe nuk e kishte parë asnjëherë vajzën e tij 21 muajshe. Disa nga këta të dyshuar janë transferuar në arrest shtëpiak, por edhe 27 shqiptarë dhe tre serbë qëndrojnë ende në paraburgim në pritje të gjyqit.<sup>229</sup> Raport i ngjajshëm vlenë edhe për rastet më të vjetra të patrajtuara: rastet serbe janë më pakta në krahasim me një të pestën e popullsisë, sa ata përbëjnë në popullsinë e regjionit. Shumica më e madhe e lëndëve përbëhet nga rastet shqiptare.<sup>230</sup>

Drejtësia penale në Veri është bllokuar nga vendimet politike në Beograd, Bruksel dhe Prishtinë. Gjyqtarët shqiptarë të gjykatës refuzojnë të dëgjojnë këto raste kudo përveç në gjykatën e Mitrovicës, për shkak se qeveria e Kosovës don të përdorë ratet e mbetura të patrajtuara për të krijuar presion për ri-integrimin e Veriut. Serbët verior refuzojnë të shkojnë në gjykatat e Republikës së Kosovës, dhe kërcënojnë me trazira në qoftë se gjykatësit shqiptarë kthehen në gjykatën e Mitrovicës. Beogradi nuk do të bie dakord me emërimin e asnjë gjyqtari të bërë sipas ligjit të Kosovës dhe do të pranojë vetëm gjyqtarët e vet. Të gjithë pajtohen që të gjykohen nga gjyqtarë ndërkom-bëtarë, por EULEX nuk ka vendosur staf të mjaftueshëm për të kompensuar mungesën e vendorëve.

E fokusuar në krijimin e një marrëveshjeje me Beogradin duke lënë anash të gjitha palët e tjera, EULEX-i u përpoq të gjejë gjyqtarë vendor të pranueshëm për të dy komunitetet, pa u sqaruar dhe pa u konsultuar me qeverinë e Kosovës, Përfaqësuesit Ndërkombëtar Civil apo me ambasadat e Kuintit para se t'i ofrojë propozim Beogradit.<sup>231</sup> EULEX-i ka propozuar emërtimin e dy gjyqtarët të nominuar kohëve të fundit nga Serbia të cilët më parë kishin punuar për UNMIK-un, duke shpresuar se pozicioni i tyre në sistemin serb do t'i bënte ata të pranue-

<sup>223</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Mitrovicë, 24 shkurt, 2010.

<sup>224</sup> 35 gjyqtarë ishin ricaktuar në tërë Kosovën, një e treta e të cilëve punon në Veri, e pjesa tjetër në enklavat në jug. Përderisa lajmi kishte shkaktuar shqetësim, këta gjyqtarë kishin qenë të paguar nga Serbia qysh nga viti 1999; ricaktimi ishte pjesë e reformës gjyqësore të Serbisë, që bëri që rreth 40 përqind të stafit në Kosovë të largohej nga pozitat që mbanin deri atëherë.

<sup>225</sup> Në atë që ishte parë si lojë e Beogradit për të vënë sa më shumë në kontroll Veriun, serbët e Kosovës që kishin punuar në gjyqësi para pavarësisë u barikaduan në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës më 14 mars, 2008, duke dashur të ndalojnë vendosjen e gjykatave nën kontrollin e Prishtinës dhe duke insistuar që të lejohen t'i kthehen punës nën legjislacionin serb. UNMIK-u i besoi inteligjencës që thoshte se pa një reagim, edhe institucionet tjera do të merreshin. Gjatë mëngjesit të hershëm të 17 marsit, forcat e speciale të UNMIK-ut hynë në gjykatë, pranguan zaptuesit dhe filluan transportimin e tyre në Prishtinë. Popullata lokale, e alarmuar nga ambulancat nëpër rrugë, u mblodh dhe filluan përlëshjet. Një polic nga Ukraina u vra; dy serbë të Kosovës vdiqën. Dita përfundoi me tërheqjen e UNMIK-ut dhe me vendosjen e thasëve me rërë rreth ndërtesës.

<sup>226</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Mitrovicë, 24 shkurt, 2010.

<sup>227</sup> Ibid.

<sup>228</sup> EULEX-i vlerëson se një gjykate me staf të plotë do t'i duhej rreth një vit e gjysëm për fshirjen e rasteve të mbledhura,

kryesisht të rasteve urgjente; intervistë e Grupit të Krizave, Dominique Orsini, EULEX, kryesues i njësisë policore, Prishtinë, 30 mars, 2010. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me 16 gjyqtarë, zgjodhi 5,343 raste më 2009; nëse gjykata e Mitrovicës punon me më pak gjyqtarë me të njëjtën shpejtësi, mesiguri do t'i duheshin 3 apo më shumë vite për të zgjidhur lëndët e grumbulluara.

<sup>229</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Mitrovicë, 24 shkurt, 2010.

<sup>230</sup> Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë serbë, Beograd, 26 mars, 2010; intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Mitrovicë, 23 shkurt, 2010.

<sup>231</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Hashim Thaçi, kryeministër, diplomatë të lartë perëndimor, Prishtinë, 12 mars, 2010; një zyrtar i sekretariatit të Këshillit të BE-së mohon fuqishëm këtë, duke thënë se Thaçi është informuar rreth marrëveshjes para se t'i afrohej Beogradit. Intervistë e Grupit të Krizave, Bruksel, 30-31 mars, 2010.

shëm për Beogradin dhe serbët lokal të Kosovës, përderisa statusi i tyre si gjyqtarë të UNMIK-ut do të lejonte që ata të mos jenë të emëruar nga Presidenti Sejdiu. Nënshkrimi i tij në fletëmërimë, në pikëpamjen serbe, do të tregonte pranimin e pavarësisë së Kosovës.

Beogradi e përshëndeti propozimin si një zbulim të madh.<sup>232</sup> Por në Këshillin Gjyqësor të Kosovës më 30 mars 2010, kjo u refuzua nga ana e lokalëve e poashtu dhe nga ana e anëtarëve të EULEX-it. Një zyrtar i lartë i EULEX-it u deklarua se duke pranuar emërimin sipas sistemit serb, gjyqtarët kishin heçur dorë nga mandati i UNMIK-ut. Një zyrtar i lartë i EULEX-it komentoi: “EULEX-i nuk është krijuar në Serbi, por është krijuar për Kosovën”.<sup>233</sup> Më 15 maj 2010, Presidenti Sejdiu në Gjykatën e Mitrovicës emëroi gjyqtarë, duke përfshirë edhe një serb.

Të gjithë janë dakord, pozitivisht, se ligji do të vendoset, për secilin rast të dëgjuar nga ana e gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.<sup>234</sup> Në shumicën e aspektëve, kodet janë të ngjashme, dhe të pandehurit serbë janë të gatshëm të pranojnë ligjet e Kosovës, sidomos në rastet ku ai është më i lehtë se sa ligji i vjetër i UNMIK-ut.<sup>235</sup> Por prioriteti duhet të jetë vendosja e gjyqtarëve të mjaftueshëm nëpër pozita sa më shpejt të jetë e mundur. EULEX duhet të propozojë një kompromis: Prishtina do të binte dakord për emërimin e dy gjyqtarëve të nominuar nga Serbia, ndoshta të bëjë formalisht ri-emërimin e tyre, përserisa Beogradi do të binte dakord për të paktën tre serbë të emëruar nga qeveria e Kosovës, së bashku me pesë gjyqtarë shqiptarë dhe dy të tjerë ndërkombëtarë. Me pesëmbëdhjetë gjyqtarë, gjykata në Mitrovicë mund të trajtojë rastet e të gjithë të paraburgosurve Brenda një periudhe përafërsisht gjashtmuajore dhe pastaj të fillojë trajtimin e lëndëve të grumbulluara.

Nëse kjo nuk arrihet, EULEX-i do të duhet të mbajë një barrë më të rëndë, duke vendosur një trup të dytë gjyqësor me tre gjyqtarë ndërkombëtarë si zgjidhje të përkohshme. Gjyqtarët e EULEX-it duhet të shfrytëzojnë në mënyrë creative stafin vendor serb dhe shqiptarë në mënyrë që të përshpejtojnë punën. Pasiqë për zyrtarët ligjorë nuk është e nevojshme të emërohen nga presidenti i Kosovës, nuk ka polemikë rreth përzgjedhjes së tyre, në fakt, avokatët serb dhe shqiptarë janë duke punuar pa problem së bashku në gjykatën e Mitrovicës. EULEX-i mund të punësojë avokatë më me përvojë – të cilët mund të jenë

edhe kandidatë për tu rekomanduar në të ardhmen – në mënyrë që personeli lokal të ketë mundësi të bëjë shumicën e punës së gjyqtarëve.<sup>236</sup> Në të njëjtën kohë, qeveria e Kosovës duhet të kthejë gjykatësit shqiptar nga ekzili i tyre në Vushtrri.

Është e rëndësishme për ta bërë këtë sa më shpejt që të jetë e mundur. Sot, serbët në veri mund të paraqiten para një gjyqtari ndërkombëtar në Mitrovicë, si dhe një thirrje (për raste të vogla), gjithashtu ka edhe ankesa (për raste të vogla) që dëgjohe në Mitrovicë. Reforma gjyqësore do të integrojë gjykatat e vendit, megjithatë, dhe do ta bëjë të vështirë për ta të marrin pjesë në integrim pa pranuar juridiksionin e Kosovës. Pasi reforma të hyjë në fuqi, të gjitha ankesat do të dëgjohe në Prishtinë, në një Gjykatë të vetme të Apelit.

### C. POLICIA

Ndër institucionet e mëdha të Kosovës, policia është i vetmi institucion që funksionon në Veri. Katër stacionet e policisë në veri janë kryesisht me personel serbë, por të gjitha këto stacione kanë disa oficerë shqiptarë të cilët kryesisht punojnë në lagjet dhe fshatrat shqiptare.<sup>237</sup> Shefat e policisë serbe nuk e gëzojnë e besimin e vendasve e as të bashkësisë ndërkombëtare dhe të Prishtinës, njëri ndër oficerët i cili ka qenë subject i katër ankesave të bëra nga Inspektoriati i Policisë së Kosovës, është parë në shoqërinë e kriminelëve të njohur.<sup>238</sup> Vendasit e shohin policinë si joefikase, të papërvajë dhe të korruptuar, përderisa politikanët serb në Mitrovicë hapur kërkojnë që ish oficerët serbë të emërohen në PK, në mënyrë që, sipas tyre, kjo forcë të përmirësohet.<sup>239</sup>

Edhe pse zyrtarisht është pjesë e të njëjtës organizatë, Policia në Veri ka kontakte mjaft të kufizuara me Policinë në Jug të lumit Ibër. Komandantët e stacionit nuk marrin pjesë shpesh në mbledhje dhe nganjëherë preferojnë të

<sup>232</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Goran Bogdanović, ministër për Kosovë e Metohi (Serbia), Beograd, 11 mars, 2010; zyrtar serb, Beograd, 26 mars, 2010.

<sup>233</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Johannes Pieter Van Vreswijk, kryeprokuror, EULEX, Prishtinë, 31 mars, 2010.

<sup>234</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Dominique Orsini, EULEX, kryesues i njësisë policore, Prishtinë, 30 mars, 2010.

<sup>235</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Mitrovicë, 24 shkurt, 2010.

<sup>236</sup> Së paku një gjykatës i cili më vonë ishte caktuar nga Serbia, i ishte afuar EULEX-it për punë si “gjykatës i EULEX-it”. Serbia i paguan rreth €1,500 në muaj, dy herë më shumë se atë që ofron Kosova; shumica besojnë se kjo është një pengesë për rekrutimin e gjykatësve serbë në Mitrovicë. Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 11 shkurt, 2010; zyrtar ndërkombëtar, Mitrovicë, 24 shkurt, 2010.

<sup>237</sup> Katër stacionet veriore kanë 189 policë serbë, 21 shqiptarë dhe 8 boshnjakë; raporti vjetor i drejtoratit rajonal të policisë së Mitrovicës, dhënë Grupit të Krizave.

<sup>238</sup> Intervista të Grupit të Krizave, politikanë serbë të Kosovës, Mitrovicë, 18 janar, 2010; zyrtarë serbë, Beograd, 11 shkurt, 2010; zyrtar i lartë i inspektoratit të policisë, Prishtinë, 15 mars 2010; zyrtar i lartë I hulumtimeve në EULEX, departamenti ekzekutiv i policisë, Prishtinë, 16 mars 2010; dhe zyrtar i lartë i shtyllës së policisë kufitare, Prishtinë, 10 shkurt, 2010.

<sup>239</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb i Kosovës, Mitrovica Veriore, 20 janar, 2010.

raportojnë në mënyrë private; ndërsa urdhrat e marrur nga eprorët shqiptarë mund edhe të shpërfillen.<sup>240</sup> Në teori, komandantët e veriut merren vetëm me EULEX-in, i cili mandej dërgon raportet e tyre në Prishtinë. Shumë oficerë në Veri marrin nga dy paga, nga Kosova dhe Serbia, edhe pse nuk ka asnjë provë që ata pranojnë udhëzime nga Serbia.<sup>241</sup> Selia qendrore rajonale në jug të Mitrovicës po përpiqet të krijojë raporte të mira me oficerët lokal serb të Kosovës – Monitoruesit e EULEX-it i përshkruajnë raportet ndërmjet tyre si “përgjithësisht të varfëra”.<sup>242</sup> Kjo është një zonë ku EULEX-i mund të jet një ndihmë e madhe. Misioni i BE-së për sundim të ligjit në Bosnje ka punuar shumë për të përmirësuar komunikimin përbrenda policisë,<sup>243</sup> por kjo nuk duket të jet një prioritet për EULEX-in, të cilët përndryshe, në një raport gjithëpërfshirës programor për vitin 2009 kishin vetëm një shënim lidhur me Mitrovicën e Veriut.<sup>244</sup>

Policia EULEX-it kanë qenë staf i padukshëm i Veriut. Dymbëdhjetë prej tyre janë paraqitur si vëzhgues në stacionet e PK-së në veri. Sigurimi i EULEX-it haptazi ruajnë gjykatën së qarkut në Mitrovicë. Rreth 30 policë kufitarë të EULEX-it dhe 20 staf doganorë gjimden në dy piakt kufitare (Portat 1 dhe 31). Edhe pse janë më shumë në numër se sa në pikat e tjera kufitare më Serbinë, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, roli i stafit të EULEX-it në këto dy pika është më kufizuar. EULEX-i ishte aty edhe gjatë krizës së Brdjani / Kroi i Vitakut që filloi nga maji 2009 e këtej, pasi shqiptarët kërkuan rindërtimin e shtëpive të shkatërruara në një lagje të Mitrovicës së Veriut. Megjithatë, përderisa njësitë e posaçme, duke përdorur gaz lotsjellës patën për qëllim parandalimin e përleshjeve midis serbëve dhe shqiptarëve, pjesëtarët e EULEX-it vepruan më shumë për të ndikuar në përmbajtjen se sa në zgjidhje të krizës.<sup>245</sup> Konsideratë më

e madhe i është kushtuar shmangjes dhe provokimit të trazirave lokale.

Kjo ka bërë që EULEX-i dhe mbështetësit e saj ndërkom-bëtar të heqin dorë nga veprimet që do të paraqiteshin si popullore në mesin e serbëve të veriut, të cilët nuk e pël-qejnë mosndëshkimin e atyre që operojnë me krimin e organizuar. Veprimet kundër zotërve vendas të drogës dhe gangsterëve të tjerë të njohur do të krijonin simapti. Ndalesat që u bëhen stafit që jeton në Veri dhe kufizimet e mëdha në vizita, e bëjnë çdo udhëtim të rëndësishëm. Zyrtarët e EULEX-it nuk mund të bëjë hetime serioze, rritka e papritur e pranisë së tyre shton tension te ven-dasit, dhe ata janë haptazi të përcjellur gjithkund sa herë që kalojnë Ibrin.<sup>246</sup> Vendet anëtare të BE-së kanë dekla-ruar kohëve të fundit se poqese anëtarë të EULEX-it do të jetonin në këtë zonë do të ishte më e lehtë për ta të familjarizohen me popullsinë dhe problemet e tyre. Kjo do të ndikonte edhe në një përmirësim të ekonomisë lokale, dhe poashtu, sipas vendeve anëtare të BE-së duhet shqyrtuar mandatin e EULEX për të qenë më i dukshëm në Veri.<sup>247</sup>

<sup>240</sup> Një komandant i policisë është nën hetime të PK-së për shkak të refuzimit të urdhërave gjatë protestës së serbëve kundër kthimit të shqiptarëve të shpërngulur në Kroin e Vitakut/Brdjani. PK-ja, nën komandantin e Mitrovicës Veriore, Milija Milošević, nuk lejoi të kthyerit të rindërtojnë shtëpive të tyre dhe lejoi demonstruesit të mblidhen. Situata u desh të zgjidhej nga njësitë speciale të EULEX-it, të cilët shfrytëzuan gaz lotsjellës. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i inspektoratit policor, Prishtinë, 15 mars, 2010.

<sup>241</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë serbë i PK-së, Prishtinë, 17 mars, 2010.

<sup>242</sup> Raporti i Programeve të EULEX-i, fq. 57.

<sup>243</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Stefan Feller, shef i misionit, policor të BE-së (EUPM), Sarajevë, 23 janar, 2009.

<sup>244</sup> Fusnota e parë tregonte vetëm se “aktivitetet e MMA-së në veri të Kosovës kanë qenë jo edhe aq të pranishme për shkak të rrethanave politike përtej fushës së këtij raporti”.

<sup>245</sup> Serbët nuk ishin të lumtur me EULEX-in, për shkak se nuk ishte më shumë si UNMIK-unë dhënien e lejeve të ndërtimit dhe në menaxhimin e te kthyerve, ndërsa shqiptarët nuk e kuptonin EULEX-i nuk përkrahte të drejtën e tyre për tu kthyer,

pasiqë gjithcka ishte bërë përmes ligjeve ekzistuese të Kosovës. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb i Kosovës, Mitrovica Veriore, 20 janar, 2010.

<sup>246</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i hulumtimeve të EULEX-it, Prishtinë, 16 mars, 2010.

<sup>247</sup> Komunikim me postë elektronike i Grupit të Krizave, zyrtarë të sekretariatit të Këshillit të Përgjithshëm të BE-së, maj, 2010



## V. KONKLUZIONE

Kosova ka disa nga komponentet bazë të një sistemi të drejtësisë, por si tërësi ai nuk funksionon: çdo pjesë vepron më vete dhe kryesisht pa u ndjerë në botën reale. Ajo që mungon është vullneti politik dhe koordinimi në nivelin e lartë, e cila mund të vijë vetëm nga puna e përbashkët e qeverisë Thaçi, BE, SHBA, ICO dhe EULEX. Përndryshe, Kosova do të mbetet vetëm me pamjen e drejtësisë, pa substance të saj, dhe populli i saj do të jetë edhe më i varfër pa te.

Shtetin e sapo pavarësuar po humb përfitime të rëndësishme që do të ofroheshin me sundimi të ligjit, kur vendime të rëndësishme bëhen në bazë të rregullave formale dhe në kuadër të institucioneve publike, dhe rezultatet janë të papërcaktuar dhe të parashikueshme. Investitorët e huaj nuk do të rrezikojnë kapitalet e konsiderueshme në Kosovë pa sigurimin se të drejtat e tyre do të jenë të mbrojtura. As ndërmarrësit kosovarë nuk do të mund të jenë të suksesshëm në një ekonomi të dominuar nga magnetë të lidhur mirë vendor.<sup>248</sup>

Performanca e sistemit gjyqësor gjithashtu ndikon në statusin ndërkombëtar të vendit. Për sa kohë vazhdon reputacioni për paligjshmëri – me apo pa të drejtë – vendet që ende nuk e kanë njohur Kosovën do të ngurrojnë ta ndryshojnë qëndrimin e tyre. Serbia do të ketë një armë të fuqishme retorike, sidomos me zhvillimin e fushatës së saj kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me të cilën ajo synon që ta bëjë veten si një udhëheqës rajonal në sundimin e ligjit.<sup>249</sup>

Gjendja e institucioneve ligjore të Kosovës, gjithsesi, përfaqëson një provë të vendimit për shpalljen e pavarësisë në shkurt 2008. Ndërsa policia, gjykatat dhe prokurorët janë duke dështuar në aspekte të rëndësishme ata janë, sic ka thënë një herë dramaturgu Samuel Beckett, janë duke dështuar më mirë.<sup>250</sup> Qeveria ka arritur, me burime modeste që ka në dispozicion, për të ndërtuar në themelet e lëkundura të bëra nga UNMIK-u. Elita politike e Kosovës ende ushqen lirinë për të vepruar pa mbikëqyrje ligjore. Shumë shpesh, kjo do të thotë thjesht duke kaluar nëpër momente, pa angazhime të vërteta politike. Por ky është një hap i parë i domosdoshëm, e që me gjasë nuk do të

ishte ndërmarrë poqese do të zvarritej procesi për statusin për disa vjet më shumë.

Pjesa më e madhe përmirësimeve ka qenë e shtyrë nga presioni ndërkombëtar, sidomos nga KE dhe SHBA-të.<sup>251</sup> Bastisjet e EULEX-it në ministrinë e transportit kanë ngritur hetimet kundër korrupsionit në një nivel më të lartë dhe duhet të kenë një efekt pozitiv në ndalimin e korrupsionit. Por, ndjekjet penale në nivel të lartë nuk janë as një zgjidhje as një provë vendimtare për sundimin e ligjit. Parandalimi është aq i rëndësishëm sa edhe ndjekjet penale; presioni ndërkombëtar duhet gjithashtu të përqëndrohet në kufizimin e mundësive për korrupsion me forcimin e kuadrit ligjor – thënë me fjalët e një vëzhguesi, duke ndryshuar “sistemi që lejon korrupsionin” në vend që të sulmohet korrupsioni si një lloj problemi abstrakt, endemik.<sup>252</sup>

Mënyra më e mirë për të bërë këtë është kompletimi i kuadrit legjislativ dhe rregullator dhe forcimi i kapacitetit të policisë, prokurorëve dhe gjykatave sa më shpejt të jetë e mundur. Të dy detyrat kërkojnë që Qeveria e Kosovës të punojnë ngushtë me përfaqësues ndërkombëtarë, sidomos me EULEX-in. Së bashku, ata do të kneë mundësi të ngushtojnë hendekun mes policisë së tanshme jofunksionale si dhe të gjyqësorit në njërin anë dhe institucioneve të reformuara në anën tjetër të cilat do të mund të formësoheshin pas 2-3 vitesh. Kosova nuk mund t’ia lejojë vetes të presë më gjatë për sundim të ligjit dhe nuk mund prosperojë me reforma të hendikepuara.

**Prishtinë/Stamboll/Bruksel, 19 maj 2010**

<sup>248</sup> Banka Botërore vëren se “kapaciteti i institucioneve nacionale për mbrojtjen e të drejtat pronësore, të redukojë koston e transakcioneve, dhe të parandalojë veprimin e dhunshëm mund të jenë vendimtare për atë se a do të ketë zhvillim ekonomik”. “Zhvillimi ekonomik dhe kualiteti i institucioneve ligjore”, Banka Botërore, fq. 1.

<sup>249</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Božidar Djelić, zëvendës kryeministër (Serbi), Beograd, 11 mars, 2010.

<sup>250</sup> “Provo përsëri, dështo përsëri. Dështo më mirë”, Samuel Beckett, *Worwaard Ho* (1983).

<sup>251</sup> Kjo nuk do të thotë se të huajt, e sidomos EULEX-i nuk kanë bërë gabime, sic do të shihet në raportin e ardhshëm.

<sup>252</sup> “Do tw bashkwpunojmw me secilin nw veri”, Arben Ahmeti, *Koha Ditore*, 29 mars, 2010.

## ANEKSI A

### HARTA E KOSOVËS



## ANEKSI B

### LISTA E SHKURTESAVE

---

KE	Komisioni Evropian
ZNKEK	Zyra Ndërlidhëse e KE në Kosovë
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për sundim të ligjit në Kosovë
PSBE	Përfaqësuesi Special e BE-së
IJU	Njësi për Hetime të Brendshme i PK-së
ZNC	Zyra Ndërkombëtare Civile
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, shefi i ZNC-së
TNKJ	Tribunali Ndërkombëtar për Krime për ish Jugosllavi
AAKK	Agjensioni Anti-Korrupsion i Kosovës
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KP	Kosovo Police
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës (nën UNMIK dhe në Veri)
ZKD	Zyra e Këshillit Disiplinor i KGJK-së
IPK	Inspektoriati i Policisë së Kosovës
KSIPSV	Krahasueshmëria e Sigurtë e Identifikimit Personal dhe Sistemi i Vlerësimit
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vet-Qeverisjes, qeveria e Kosovës nën UNMIK
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ENLPKD	Emërimet e Nivelit të Lartë në Polici dhe Komisionet Disiplinore
KB	Kombet e Bashkuara
RKSKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit e KB
MKAKB	Misioni i Përkohshëm i Administrimit të KB
AZHNSHB	Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara